- Zhvillimin e një koncepti urban me zona urbane banimi si dhe zona më të dendura të përziera urbane;
- Zhvillimi i një mjedisi të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm,;
- Zhvillimi i kushteve për biznes në zonat e përziera;
- Zhvillimi i infrastrukturës relevante shoqërore sikurse shkollat, qendrat për perkujdesje, shërbimet shëndetësore;
- Zhvillimi i infrastrukturës relevante teknike në zonë;
- Minimizimi i ndotjes së ajrit duke promovuar përdorimin e burimeve alternative të energjisë;
- Minimizimi i sasisë së ujit të shiut në sistemin e kanalizimit dhe promovimi i drenazimit të ujit atmosferik duke i minimizuar sipërfaqet e mbyllura;
- Krijimi i rrugëve të reja dhe zgjerimi, rregullimi i rrugëve ekzistuese
- Zhvillimi i rrugëve dhe udhëkryqeve në zonë në rrugë dhe sheshe atraktive urbane.

### 7.2 Programi

Programi për planin struktural dhe Planin rregullues urbanistik të Muhaxhirëve bazohet në Profilin Urban, qëllimet si dhe Planin Strategjik 2004-2020.

Zona do të riorganizohet, do të zhvillohet në lagje të shëndoshë, dhe mjedisore të Prishtinës. Zhvillimi i një zonë të kësaj madhësie mund të merr 10-15 vite, dhe nevojat e kërkesat në këtë zonë mund të ndryshojnë gjatë kësaj periudhe. Prandaj është e rëndësishme të krijohet një strukturë urbane stabile, që është mjaftë fleksibile për të reaguar ndaj ndryshimeve gjatë kësaj kohe të zhvillimit.

Zona duhet të plotësojë nevojat për infrastrukturë shoqërore sikurse shkollat, qendrat e perkujdesit, dhe shërbimet shëndetësore. Zhvillimi i infrastrukturës shoqërore duhet të jetë fleksibil për të reaguar ndaj kërkesave ndryshuese.

Do të zhvillohet një sistem i komunikacionit dhe transportit, që do të shërbejë jo vetëm për banorët e ardhshëm të zonës së planit rregullues urbanistik, por edhe që jep qasje më të mirë tërë zones së Prishtinës. Rrugët në zonë do të zhvillohen sipas kërkesave teknike të komunikacionit.

Struktura ekzistuese urbane mundet të ruhet. Shfrytëzimi për banim do të lejohet përgjatë gjithë zonës sikur edhe permbajtjet tjera : administratë, bizens jo shqetësues, furnizimi me ushqim dhe shfrytëzime të tjera.

Shfrytëzimi kryesor përgjate rrugëve periferike të lagjes do të jetë me natyrë më shumë sociale, me administratë dhe biznes, të përziera së bashku me banim.

Është siguruar shfrytëzimi i mëtutjeshme i dy shkollëve fillore dhe janë propozuar disa lokacione të përshtatshëm për ndertimin e çerdheve si dhe një loacion për një shkollë të mesme.

Do të sigurohet sipërfaqe e mjaftueshme për zhvillimin e nevojshëm të infrastrukturës teknike.

Kapaciteti i trafikut do të rritet. Duke pas parasysh vështirësinë e ndërtimit të rrugëve të reja, duhet shfrytëzuar rrjetin ekzistues duke u bërë zgjerimi i rrugëve sipas normativave teknike dhe në disa vende do hapen rrugë të reja. Sistemi hierarkik i cili paraqitet do të koncentroj trafikun në disa rrugë kryesore dhe kapaciteti i këtyre rrugëve kryesore do të rritet.

Është propozuar zgjidhja për problemin e parkingut, si për banorët ashtu edhe për parkingun e përkohshëm.

*Bota është në lëvizje! Janë pikërisht qytetet që e vënë atë në lëvizje. Dhe pikërisht prej këtu duhet të vijë edhe idetë dhe zgjidhjet për burimet materiale e financiare si edhe, zgjidhjet e duhura për problemet e shumta.*

*Konkluzion nga Forumi Urban Botëror i Barcelonës.*

## 8 Plani Struktural

### 8.1 Struktura Urbane

Në zonën e Muhaxhirëve mund të identifikohen 5 (pesë) terësi pjesë përbërëse:

- Zona Mikse "ZM" (tërësia A)**  
Përbehet nga bërthama e qytetit që është pjesa përcaktuese e lagjes së Muhaxhirëve;
- Zona Mikse "ZM" (tërësia B)**  
Në pjesën qendrore dhe veriore të lagjes që mbulohet me shtëpitë pothuajse të ngjitura me njëratjetrën shtrihet tërësia B që ndahet në 4 nëntërësi; B-1, B-2, B-3 dhe B-4.
- zona e Konzervuar e Banimit "KB" (tërësia C)**  
Në pjesën lindore dhe jug-lindore të lagjes që përfshinë "Banesat e bardha" është planifikuar që të konzervohet gjendja si e tillë me përjashtim të një institucioni parashkollor për nevojat e banoreve.
- zona e Konzervuar Publike "KP" (tërësia D)**  
Në këtë zonë përfshihen objektet për shërbime publike **ekzistuese** si:  
Ministritë; Fakulteti i Arkitekturës; Shkolla fillore dhe ajo e mesme e ulët "Naim Frashri"; shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Iliria"; xhamia "Kadërie"; "Stacioni i policisë nr2". Të cilat do të konzervohen si të filla dhe të **planifikuara** si:  
Objekti administratës komunale; Qendra e mjekësisë familjare, qendra takimi dhe rekreacioni për të rinjë, etj; një shkollë e Mesme në afërsi të shkollës ekzistues "Iliria"
- zona e parkut memorial "PM" (tërësia E)**  
Në pjesën qendrore të lagjes që përfshinë pjesën e gjelbëruar të varrezave të dëshmorëve dhe varrin e presidentit "Ibrahim Rugova" parashihet konzervim i gjendjes ekzistuese e në të ardhmen rehabilitimi i saj.

Këto qendra të banuar e posaçërisht tërësia **A** dhe **B** janë ato që do të zhvillohen në veçanti në të ardhmen dhe janë një potencial për këtë lagje.

### 8.2 Plani Struktural i detajuar




fig. 22. Tërësitë dhe nëntërësitë e lagjes

Pas shumë analizash kemi arritur në përfundim që për mundësi implementimi të planit duke pasur parasysh gjendjen kaotike të lagjes dhe për një jetë kualitative të banorëve e vetmja mënyrë që të jenë të gjithë qytetarët të barabartë dhe të kënaqur është që të stimulohet qytetari me koeficienta më të lartë në mënyrë që të bashkohet me fajun dhe të ketë leverdi ndërtimi dhe bashkimi.

Pavarsisht nga kjo kemi 3 skenarët e prezentuar 1, 2 dhe 3 që do parashikohen në tërësitë apo nëntërësitë e lagjes gjatë hartimit të zgjidhjes urb-arkitetktonike.

Në tabelën që vijon janë treguar parametrat e shfrytëzimit dhe dendësisë.

Kemi 3 kategori të ndarjes, dhe të trajtimit të parcelave,

- për ngastra: 100-450 m<sup>2</sup>;
- për ngastra: 450-1000 m<sup>2</sup>;
- për ngastra: mbi 1000m<sup>2</sup>

TREGUESIT NDËRTIMOR / BUILDING CODES / GRADJ. POKAZATELJI		
<b>Për ngastra kadastrale me sipërfaqe 100-450m<sup>2</sup></b>		
Etazhiteti maksimal	3 (P+2)	
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës, Max.	ISHP=0.40	
Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë, Max.	ISD=1.0	
Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit, Max.	ISG=0.50	
Shfrytëzimi Max. nën tokë	Suterani	0.40
	Bodrumi	0.60
<b>Për ngastra kadastrale me sipërfaqe 450 -1000m<sup>2</sup></b>		
Etazhiteti maksimal	6 (P+5)	
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës, Max.	ISHP=0.40	
Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë, Max.	ISD=2.4	
Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit, Max.	ISG=0.50	
Shfrytëzimi Max. nën tokë	Suterani	0.40
	Bodrumi	0.60
<b>Për ngastra kadastrale me sipërfaqe mbi-1000m<sup>2</sup></b>		
Etazhiteti maksimal	i pa limituar	
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës, Max.	ISHP=0.40	
Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë, Max.	ISD=4.0	
Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit, Max.	ISG=0.50	
Shfrytëzimi Max. nën tokë	Suterani	0.40
	Bodrumi	0.70

fig. 23. Tabela e koeficienteve të ndërtimit



Sipërfaqet e kufizuara në pikat **a**, **b**, dhe **c** të këtyre kriterëve bazë, të përcaktuara me këtë tabelë, do të rumbullakohen.

Rrumbullakimi ka të bëjë vetëm me kufirin maksimal të sipërfaqes së pikës përkatëse ndaj kufizimit minimal të sipërfaqes me pikën vijuese, dhe ka qëllim zbatimin e kriterëve vijuese, si p.sh.

**Pika a;** *Sipërfaqja 95m<sup>2</sup> rumbullakohet në 100m<sup>2</sup> dhe zbatohen kriteret e parapara në pikën 1;*

**pika b;** *Sipërfaqja 425m<sup>2</sup> rumbullakohet në 450m<sup>2</sup> dhe zbatohen kriteret e parapara në pikën 2;*

**pika c;** *Sipërfaqja 955m<sup>2</sup> rumbullakohet në 1000m<sup>2</sup> dhe zbatohen kriteret e parapara në pikën 3;*

tërësia	nëntërësia	shfrytëzimi	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Përqindja %
<b>A</b>		zone mikse (ZM)	43,444	7.12%
<b>B</b>	<b>B-1</b>	zone mikse (ZM)	93,280	15.29%
	<b>B-2</b>		69,524	11.40%
	<b>B-3</b>		74,124	12.15%
	<b>B-4</b>		<b>38,750</b>	6.35%
<b>C</b>		konzervim banimi (KB)	65,575	10.75%
<b>D</b>		konzervim publik (KP)	54,274	8.90%
<b>E</b>		parku memorial (PM)	44,346	7.27%
Infrastruktura e rrugëve (I)			126,683	20.77%
<b>TOTALI:</b>			<b>610,000</b>	<b>100.0%</b>

fig. 24. Tabela e sipërfaqeve të tërësive dhe nëntërësive



## 9 KARAKTERISTIKAT E TËRËSIVE URBANE A, B, C, D dhe E

## 9.1 Tërësia "A" - Zonë Mikse (ZM)

SNT – Sipërfaqja Neto e Tërësisë „A“ është 4.3Ha  
SBT – Sipërfaqja Bruto e Tërësisë „A“ është 5.3Ha

Tërësia „A „ përfshinë 7.12% te komplet lagjes, ndahet në 4 blloqe:

Tërësia	nëntërësia	blloku	Qëllimi i përdorimit	SBN S.Neto e blo. (m <sup>2</sup> )	SBB S.Bruto e blo. (m <sup>2</sup> )	përqindja në lagje
A	A	a-01	ZM + I	15,968	19,144	
		a-02	ZM	6,016	8,367	
		a-03	ZM	4,714	6,545	
		a-04	ZM	16,746	19,654	
total A:				43,444	53,710	7.12%

### Kushtet e përgjithshme

#### Qëllimi i përdorimit:

Përdorim komercial jo shqetësues, administratë, biznes i kombinuar me banim kolektiv.

#### Lejohet:

Zonat Mikse me shfrytëzim të përzier kryesisht do të sigurojnë hapësirën për përdorim komercial, dhe për banim.

Janë të lejuara këto përdorime:

- Ndërtesat për administratë, biznes dhe zyre;
- Ndërtesat e banimit rezidencial;
- Shitje me pakicë, tregti ushqimor dhe akomoduese;
- Përdorime tjera komerciale jo shqetësuese.

Lartësia e lejuar në këtë zonë duke u bazuar në koeficientat e dhënë mund të jetë deri në 10 kt. (P+9), Në rast se bëhet bashkimi i pronarëve për investim të përbashkët arrihen koeficientat e pikes 3 nga fig. 23 ku ngastra minimale është 955m<sup>2</sup>.

Në këtë zonë duhet të kemi hapësirë të gjelbërt (min. 50% të sip. së hapësirës) Mundësohet shfrytëzimi i suteranit nëse i përshtatet terreni ekzistues deri në 40% të sipërfaqes. Bodrumi mund të shfrytëzohet deri në 70% të sipërfaqes që kryesisht do shërbejë për garazhim.

**Me miratimin e planit duhet të hartohen pjesët e planit të hollësishëm detaj me 3 variante (ku do përfshihen të gjitha hollësitat, parametrat, infrastruktura brenda parcelave urbane të banimit ku mund të ketë inkorporime, ndërsa rrugët kryesore nuk do të pësojnë ndryshime, Planet e hollësishme detaje duhet të përmbajnë hapësirat e gjelbërta, të rekreacionit, parkingjet, rrugët e brendshme, trotualet, hapësirat për infrastrukturë teknike (furnizimi me ujë, kanalizim, ngrohja, rryma, telefonia, internet, etj) Me rastin e përpunimit të zgjidhjes urb-arkitektonike të bllokut riparcelimi duhet të bëhet në marrëveshje me të gjithë pronarët përkatës të bllokut.**



fig. 25. Tërësia "A"

#### TREGUESIT NDËRTIMOR / BUILDING CODES / GRADJ. POKAZATELJI

Për ngastra kadastrale me sipërfaqe 100-450m <sup>2</sup>		
	Etazhiteti maksimal	3 (P+2)
	Indeksi i shfrytëzimit të parcelës, Max.	ISHP=0.40
1.0	Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë, Max.	ISD=1.0
	Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit, Max.	ISG=0.50
Shfrytëzimi Max. nën tokë	Suterani	0.40
	Bodrumi	0.60
Për ngastra kadastrale me sipërfaqe 450 - 1000m <sup>2</sup>		
	Etazhiteti maksimal	6(P+5)
	Indeksi i shfrytëzimit të parcelës, Max.	ISHP=0.40
2.0	Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë, Max.	ISD=2.4
	Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit, Max.	ISG=0.50
Shfrytëzimi Max. nën tokë	Suterani	0.40
	Bodrumi	0.60
Për ngastra kadastrale me sipërfaqe mbi-1000m <sup>2</sup>		
	Etazhiteti maksimal	i pa limituar
	Indeksi i shfrytëzimit të parcelës, Max.	ISHP=0.40
3.0	Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë, Max.	ISD=4.0
	Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit, Max.	ISG=0.50
Shfrytëzimi Max. nën tokë	Suterani	0.40
	Bodrumi	0.70

Pjesa Perëndimore e lagjes që lidhet me qendrën e qytetit ka një potencila dhe mundësi të shkojë në lartësi duke u bazuar me pjesën që e rrethon, me nevojën dhe me terrenin ekzistues.

Gjatë zgjidhjes urb-arkitektonike të bllokut duhet të vendoset 1 institucion parashkollor. Për shkak të nevojës dhe pozitës në kemi propozuara bllokun a-01, por gjatë përpilimit të zgjidhjes ideore mund të ndryshojë.

## 9.2 Tërësia "B" dhe Nëntërësitë - Zonë Mikse (ZM)




fig. 26. Tërësia "B" - nëntërësitë B-1, B-2, B-3 dhe B-4.

### TREGUESIT NDËRTIMOR / BUILDING CODES / GRADJ. POKAZATELJI

Për ngastra kadastrale me sipërfaqe 100-450m <sup>2</sup>		
Etazhitefi maksimal	3 (P+2)	
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës, Max.	ISHP=0.40	
1.0 Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë, Max.	ISD=1.0	
Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit, Max.	ISG=0.50	
Shfrytëzimi Max. nën tokë	Sutereni	0.40
	Bodrumi	0.60
Për ngastra kadastrale me sipërfaqe 450 - 1000m <sup>2</sup>		
Etazhitefi maksimal	6 (P+5)	
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës, Max.	ISHP=0.40	
2.0 Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë, Max.	ISD=2.4	
Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit, Max.	ISG=0.50	
Shfrytëzimi Max. nën tokë	Sutereni	0.40
	Bodrumi	0.60
Për ngastra kadastrale me sipërfaqe mbi-1000m <sup>2</sup>		
Etazhitefi maksimal	i pa limituar	
Indeksi i shfrytëzimit të parcelës, Max.	ISHP=0.40	
3.0 Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë, Max.	ISD=4.0	
Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit, Max.	ISG=0.50	
Shfrytëzimi Max. nën tokë	Sutereni	0.40
	Bodrumi	0.70

Tërësia B që është pjesa më e madhe e lagjes – pjesa qendrore e saj për shkak të sipërfaqes së madhe që ka ndahet në 4 nëntërësi në mënyrë që të mundësohet analiza dhe përpunimi më i sakt i kërkesave të nevojshme për implementim.

SNT – Sipërfaqja Neto e Tërësisë „B” është 27.7Ha  
SBT – Sipërfaqja Bruto e Tërësisë „B” është 33.4Ha

Tërësia „B,” ndahet në 4 nëntërësi:

Tërësia	nëntërësia	blloku	Qëllimi i përdorimit	SBN S.Neto e bll. (m <sup>2</sup> )	SBB S.Bruto e bll. (m <sup>2</sup> )	përqindja në lagje
	totali B-1			93,280	113,504	15.29%
	totali B-2			69,524	81,659	11.40%
	totali B-3			74,124	88,976	12.15%
	totali B-4			40,389	50,059	6.62%
	total B:			277,317	334,198	45.46%

### Kushtet e përgjithshme

Qëllimi i përdorimit:

Përdorim komercial jo shqetësues, administratë, biznes i kombinuar me banim kolektiv.

Lejohet:

Zonat Mikse me shfrytëzim të përzier kryesisht do të sigurojnë hapësirën për përdorim komercial, dhe për banim.

Janë të lejuara këto përdorime:

- Ndërtesat për administratë, biznes dhe zyre;
- Ndërtesat e banimit rezidencial;
- Shitje me pakicë, tregti ushqimor dhe akomoduese;
- Përdorime tjera komerciale jo shqetësuese.

Lartësia e lejuar në këtë zonë duke u bazuar në koeficientat e dhënë mund të jetë deri në 8 kt. (P+7), Në rast se bëhet bashkimi i pronarëve për investim të përbashkët arrihen koeficientat e pikes 3 nga fig. 23 ku ngastra minimale është 955m<sup>2</sup>.

Në këtë zonë duhet të kemi hapësirë të gjelbërt (min. 50% të sip. së hapësirës)

Mundësohet shfrytëzimi i suterenit nëse i përshtatet terreni ekzistues deri në 40% të sipërfaqes.

Bodrumi mund të shfrytëzohet deri në 70% të sipërfaqes që kryesisht do shërbejë për garazhim.

*Me miratimin e planit duhet të hartohen pjesët e planit të hollësishëm detaj me 3 variante (ku do përfshihen të gjitha hollësitat, parametrat, infrastruktura brenda parcelave urbane të banimit ku mund të ketë inkorporime, ndërsa rrugët kryesore nuk do të pësojnë ndryshime, Planet e hollësishme detaje duhet të përmbajnë hapësirat e gjelbërta, të rekreacionit, parkingjet, rrugët e brendshme, trotualet, hapësirat për infrastrukturë teknike (furnizimi me ujë, kanalizim, ngrohja, rryma, telefonia, internet, etj)*

*Me rastin e përpunimit të zgjidhjes urb-arkitektonike të bllokut riparcelimi duhet të bëhet në marrëveshje me të gjithë pronarët përkatës të bllokut.*

### 9.2.1 Nëntërsia "B-1" (ZM)



fig. 27. Nëntërsia B-1

SNN – Sipërfaqja Neto e Nëntërsisë „B-1“ është 9.3Ha  
SBN – Sipërfaqja Bruto e Nëntërsisë „B-1“ është 11.3Ha

Nëntërsia „B-1„ ndahet në 6 blloqe:

nëntërsia	blloku	Qëllimi i përdorimit	SBN S.Netto e blo. (m <sup>2</sup> )	SBB S.Bruto e blo. (m <sup>2</sup> )	përqindja në lagje
B-1	b-01	ZM	13,215	16,595	
	b-02	ZM + I	9,647	12,157	
	b-03	ZM	14,395	17,465	
	b-04	ZM + I	22,546	27,064	
	b-05	ZM	14,115	17,411	
	b-06	ZM + I	19,362	22,812	
totali B-1			93,280	113,504	15.29%

Nëntërsia B-1 përbëhet nga 6 blloqe dhe zën një sipërfaqe të madhe të lagjes, 15.3% prandaj duhet ti kushtohet kujdes i veçantë gjatë zgjidhjes urb-arkitektonike të saj. Blloqet duhet të komunikojnë në mes vetes si dhe me tërësitë e tjera duke ruajtur kontinuitetin dhe rrjedhshmërinë e formës dhe funksionit. Gjatë zgjidhjes urb-arkitektonike të nëntërsisë duhet të vendosen 3 institucione parashkollore. Për shkak të nevojës dhe distancave ne kemi propozuara blloqet b-02, b-05 dhe b-06 por gjatë përpilimit të zgjidhjes ideore mund të ndryshojnë.

### 9.2.2 Nëntërsia "B-2" (ZM)



fig. 28. Nëntërsia B-2

SNN – „B-2“ është 6.9Ha  
SBN – „B-2“ është 8.2Ha

Nëntërsia „B-2„ ndahet në 4 blloqe:

nëntërsia	blloku	Qëllimi i përdorimit	SBN S.Netto e blo. (m <sup>2</sup> )	SBB S.Bruto e blo. (m <sup>2</sup> )	përqindja në lagje
B-2	b-07	ZM	15,209	18,608	
	b-08	ZM	16,242	18,228	
	b-09	ZM + I	35,099	39,936	
	b-10	ZM	2,974	4,887	
totali B-2			69,524	81,659	11.40%

Nëntërsia B-2 përbëhet nga 4 blloqe dhe zën një sipërfaqe prej 11.4% të lagjes. Blloqet duhet të komunikojnë në mes vetes si dhe me tërësitë e tjera duke ruajtur kontinuitetin dhe rrjedhshmërinë e formës dhe funksionit. Gjatë zgjidhjes urb-arkitektonike të nëntërsisë duhet të vendoset 1 institucion parashkollor. Për shkak të nevojës dhe pozitës ne kemi propozuara bllokun b-09, por gjatë përpilimit të zgjidhjes ideore mund të ndryshojë.

### 9.2.3 Nëntërsia "B-3" (ZM)



fig. 29. Nëntërsia B-3

SNN – „B-3“ është 7.4 Ha  
SBN – „B-3“ është 8.9 Ha

Nëntërsia „B-3„ ndahet në 5 blloqe:

nëntërsia	blloku	Qëllimi i përdorimit	SBN S.Netto e blo. (m <sup>2</sup> )	SBB S.Bruto e blo. (m <sup>2</sup> )	përqindja në lagje
B-3	b-11	ZM + I	22,262	25,975	
	b-12	ZM	18,136	21,909	
	b-13	ZM	8,337	10,336	
	b-14	ZM + I	10,990	13,669	
	b-15	ZM	14,399	17,087	
	b-16	ZM	3,110	3,500	
totali B-3			77,234	92,476	12.55%

Nëntërsia B-3 përbëhet nga 5 blloqe dhe zën një sipërfaqe prej 12.1% të lagjes. Blloqet duhet të komunikojnë në mes vetes si dhe me tërësitë e tjera duke ruajtur kontinuitetin dhe rrjedhshmërinë e formës dhe funksionit. Gjatë zgjidhjes urb-arkitektonike të blloqeve duhet të vendosen 2 institucione parashkollore. Për shkak të nevojës dhe distancave ne kemi propozuara blloqet b-11 dhe b-14 por gjatë përpilimit të zgjidhjes ideore mund të ndryshojnë.

### 9.2.4 Nëntërsia "B-4" (ZM)



fig. 30. Nëntërsia B-4

SNN – „B-4“ është 3.9 Ha  
SBN – „B-4“ është 5.0 Ha

Nëntërsia „B-4„ ndahet në 3 blloqe:

nëntërsia	blloku	Qëllimi i përdorimit	SBN S.Netto e blo. (m <sup>2</sup> )	SBB S.Bruto e blo. (m <sup>2</sup> )	përqindja në lagje
B-4	b-16	ZM	4,599	6,886	
	b-17	ZM	17,361	22,385	
	b-18	ZM + I	16,790	20,788	
totali B-4			38,750	50,059	6.35%

Nëntërsia B-4 përbëhet nga 3 blloqe dhe zën një sipërfaqe prej 6.3% të lagjes. Blloqet duhet të komunikojnë në mes vetes si dhe me tërësitë e tjera duke ruajtur kontinuitetin dhe rrjedhshmërinë e formës dhe funksionit. Gjatë zgjidhjes urb-arkitektonike të blloqeve duhet të vendoset 1 institucion parashkollor. Për shkak të nevojës dhe pozitës ne kemi propozuara bllokun b-18, por gjatë përpilimit të zgjidhjes ideore mund të ndryshojë.



### Vërejtje:

Si rezultat i vërejtjes së Kuvendit Komunal dt. 24/06/2010 është ndërruar propozimi i nëntërësisë B-4 për shkak të dëmtimit të objekteve ekzistuese (sidomos ob. me kode: E128 dhe E129) nga rrugët e propozuara dhe është bërë propozimi i prezentuar më poshtë nepiken 9.2.5 që gjatë zgjidhjes detaje duhet të analizohet dhe studiohet më gjerësisht.

Për këtë fazë ngelet si një propozim i mundshëm por gjatë punimit të zgjidhjes urb-arkitektonike do ketë mundësi të plotësimeve ose ndryshimeve eventuale por gjithmonë duke ruajtur natyrën dhe formën konceptuale të zonës në tërësi.

### 9.2.5 Propozimi i Nëntërësisë "B-4" (ZM)



fig. 31. Nëntërësisë B-4-e propozuar

SNN – „B-4“ është 4.0 Ha

SBN – „B-4“ është 5.0 Ha

Nëntërësia „B-4„ ndahet në 2 blloqe:

nëntërësia	blloku	Qëllimi i përdorimit	SBN S.Neto e bllo. (m <sup>2</sup> )	SBB S.Bruto e bllo. (m <sup>2</sup> )	përqindja në lagje
B-4	b-17	ZM	21,695	27,121	
	b-18	ZM + I	18,694	22,938	
totali B-4			40,389	50,059	6.62%

Nëntërësia e propozuar B-4 përbëhet nga 2 blloqe dhe zën një sipërfaqe prej 6.6% të lagjes. Nëntërësitë duhet të komunikojnë në mes vetes si dhe me tërësitë e tjera duke ruajtur kontinuitetin dhe rrjedhshmërinë e formës dhe funksionit.

Gjatë zgjidhjes urb-arkitektonike të blloqeve duhet të vendoset 1 institucion parashkollor. Për shkak të nevojës dhe pozitës në kemi propozuara bllokun b-17, por gjatë përpilimit të zgjidhjes ideore mund të ndryshojë.

### 9.3 Tërësia "C" zonë e konzervuar Banimi (KB)



fig. 32. Tërësia "C"

SNT „C“ = 6.6Ha

SBT „C“ = 7.8Ha

Tërësia „C „ ndahet në 3 blloqe:

nëntërësia	blloku	Qëllimi i përdorimit	SBN S.Neto e bllo. (m <sup>2</sup> )	SBB S.Bruto e bllo. (m <sup>2</sup> )	përqindja në lagje
C	c-01	KB	8,382	9,846	
	c-02	KB + I	39,476	47,624	
	c-03	KB	17,717	20,963	
total C:			65,575	78,433	10.75%

Kjo tërësi duhet të konzervohet, të ruhet gjendja ekzistuese përveç që në bllokun c-02 planifikohet të bëhet një objekt i infrastrukturës sociale-Çerdhe-kopësht meqë është edhe pronë komunale dhe është e nevojshme për banorët e zonës.

Në pjesën tjetër do të ruhen koeficientat aktual të shputës 0.20-0.25 duke mbajtur cilësinë dhe komoditetin e jetës që kanë.

Në këto tërësi nuk ka garazhim nëntokësor, por ka parking mbitokësorë që i plotëson kërkesat e banorëve të atyre blloqeve. Në këto tërësi sipas të dhënave nga Profili Urban jetojnë rreth 3.300 banorë.

#### 9.4 Tërësia "D" zonë e konzervuar Publike (KP)



fig. 33. Tërësia "D"

##### Vërejtje:

Si rezultat i vërejtjes së Kuvendit Komunal dt. 24/06/2010 është ndërruar propozimi i tërësisë D në pjesën verilindore për shkak të dëmtimit të objekteve ekzistuese dhe keto objekte kanë formuar një bllokë të ri b-16 me karakteristika të nëntërësisë B-3.

SNT „D“ = 5.4Ha

SBT „D“ = 6.1Ha

Tërësia „D“ ndahet në 4 blloqe:

D	d-01	KP	21,694	23,361	
	d-02	KP + I	4,863	6,715	
	d-03	KP	14,599	15,100	
	d-04	KP + I	10,014	10,786	
total D:			54,274	61,303	8.50%

Këto blloqe janë në përgjithësi prona komunale që do konzervohen si të tilla.

- **Blloku d-01** Do të konzervohet si i tillës që përmban objektet e ministrisë, fakultetin e arkitekturës dhe shkollën fillore Naim Frashri që planifikohet të zgjerohet
- **Blloku d-02** është paraparë një objekt administrativ dhe qendër e mjekësisë familjare githashtu edhe hapësira tjera për të rinjë, biblioteka, rekreacion, etj.
- **Blloku d-03** ku gjindet objekti ekzistues i shkollës fillore „Iliria“ do konzervohet me mundësi zgjerimi sipas nevojës. Është planifikuar që të heqen disa shtëpi individuale në pronën komunale që pengojnë zhvillimin e hapësirës por këto do të detajohen gjatë zgjidhjes ideore detaje.

- **Blloku d-04** është lokacioni më i përshtatshëm për një objekt të ri të shkollës së mesme që është i nevojshëm për banorët e kësaj lagjeje dhe atyre përreth. Prona sipas dokumentacionit që posedojmë është pronë komunale dhe për pronarët duhet të mendohet mënyra e kompensimit gjatë përpilimit të planit detaj.

#### 9.5 Tërësia "E" zona e Parkut Memorial (PM)



fig. 34. Tërësia "E"

SBT „E“ = 5.3Ha

SNT „E“ = 4.4Ha

total E:	44,346	52,765	7.27%
----------	--------	--------	-------

Zona e parkut memorial ka një sipërfaqe neto prej 4.4ha.ku do të ruhet destinim kulturo-historik, varrezat e dëshmorëve, varri i presidentit Ibrahim Rugova.

Duhet të organizohet dhe të mirëmbahet gjelbërimi ekzistues si dhe ti jepet përmbajtja kësaj hapësire gjatë punimit të zgjidhjes urb-arkitektonike të zonës. Për shkak të vlerës kulturo-historike për lagjen, për Prishtinën dhe për Kosovën ky bllok në të ardhmen do të trajtohet në veçanti dhe do të jetë shumë i vizituar ndaj është propozuar që të ketë parking mbitokësor në 0° për qark bllokut.



## 10BILANSI I KAPACITETIT TË SIPËRFAQEVE SIPAS PRRU ME 3 SKENARËT E MUNDSHËM

Sipas PRRU të Muhaxhirëve kemi paraparë 3 skenarët e mundshëm të zhvillimit të hapësirës dhe i kemi elaboruar në 3 tabela të veçanta ku jepen të gjithë parametrat e organizimit të hapësirës. Gjatë fazës së punimit të planeve urb-arkitektonike do të definohet saktësisht se në cilat tërësi gjegjësisht nëntërësi do përdoret njëri prej 3 skenarëve.

Në tabelat e bilansit të sipërfaqeve në fig.32, 33 dhe fig.34 janë dhënë parametrat që do të shërbejnë si bazë për organizimin e tërësive, nëntërësive si dhe blloqeve të veçanta.

Gjatë llogaritjes së koeficientave të 3 skenarët janë përdorur normativat siç vijojnë:

<b>normat e përdorura për</b>		
Sipërfaqja mesatare për 1 apartament	80	m <sup>2</sup>
Nr. mesatar i ban. për 1 apartament	4	banorë
Nr. i femijeve parashkollorë për 1000 banorë	70	femijë
Nr. i garazhimeve për 1 apartament	1.5	garazhim
Sip. e afarizmit për 1 garazhim/vendparkim	30	m <sup>2</sup>
Sasi e mbeturinave kg/banore, ditë	1.6	kg

Gjatë Fazës së ardhme të punimit të planeve ideore urb-arkitektonike do të shfrytëzohet njëra prej tabelave të mëposhtme dhe do elaborohet në detaje.

Të gjithë parametrat e nevojshëm si: Sipërfaqet e banimit, numri i kateve, destinimi i sipërfaqeve, nr. i familjeve, banorëve, fëmijëve, garazhave, sasia e mbeturinve, dendësia, etj. Janë specifikuar për tre skenarët e mundshëm.

Në fig.35 është dhënë një dispozitë e mundshme tredimensionale që e ilustron vizionin e mundshëm konceptual të zhvillimit të lagjes në të ardhmen.

Gjithashtu është dhënë edhe prerja-dukja gjatësore e lagjes ku shihen distancat, lartësitë dhe terreni ekzistues i lagjes.










fig. 38. Dispozita 3-D dhe Prerja



## 1.1 TRAFIKU DHE TRANSPORTI

### Hyrje

Rrjeti ekzistues rrugor i lagjes së Muhaxhirëve përbehet nga rrugët me gjerësi joadekuate të shiritave pothuajse në tërë gjatësinë e rrugëve (përveç pjesës së rrugëve në hyrje te lagjes nga rruga kryesore; Agim Ramadani;). Elementet gjeometrike të rrugëve ekzistuese nuk i përgjigjen shkallës së motorizimit dhe numrit të banorëve.

Si rezultat i karakteristikave të sipërpërmendura nuk është i mundur qarkullimi i autobusëve urban, çka ka stimuluar zhvillimin e transportit individual dhe formave tjera të paorganizuar të shërbimeve të transportit ( taxi, kombibusë ).

Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të rrjetit rrugor, si dhe në zgjidhjen e propozuar, rrjeti rrugor i lagjes së Muhaxhirëve është përpiluar sipas këtyre parimeve:

- Ruajtja e trasës ekzistuese të rrugëve (shmangie minimale nga traseja ekzistuese),
- Orientimi i qarkullimit të automjeteve në rrugët sekondare që përshkojnë lagjen në mënyrë tërthore
- Prej **burimit** e deri në **destinim**, shfrytëzuesi i rrugës të ketë më tepër se një alternativë.

### Kategorizimi i rrugëve

fleta nr.05



fig. 39. Kategorizimi i rrugëve

Në kuadër të variantit të propozuar në mënyrë të veçantë është paraparë klasifikimi i rrugëve në:

- Rrugë primare ( gjerësia e shiritit 3.5 m),
- Rrugë sekondare ( gjerësia e shiritit 3.25 m),
- Rruge terciare (gjerësia e shiritit 3.0 m)

### Rrugët Primare:

Rruge e kapacitetit më të lartë në kuadër të rrugëve urbane, të cilat tregojnë një ngarkesë trafiku të mesme-te lartë, të cilat kanë funksionet e mëposhtme:

- lidhin zonën me qendrën e lagjes dhe rrugët tjera me hyrje për në qendër
- kalojnë në qendër të lagjes,
- lidhin direkt njësitë e ndryshme të lagjes

### Rrugët Sekondare:

Rruge urbane me kapacitet të mesëm, me funksionet e mëposhtme:

- mbledhjen/shpërndarjen e trafikut ndërmjet rrugëve primare dhe linjat me kapacitet të ulët të rrjetit
- nën-lidhjet me rrugët tjera në kuadër të lagjes

### Rrugët terciare :

Rrugët urbane me kapacitet të ulët me hyrje lokale për një zonë të caktuar.

### Kapaciteti dhe niveli i shërbimit i shiritave qarkullues

Kapaciteti është shkalla maksimale gjatë së cilës automjetet mund të kalojnë në një pikë ose pjesë të rrugës gjatë periudhës kohore të dhënë nën kushtet ekzistuese të rrugës, të trafikut dhe të kontrollit. Kushtet ekzistuese rrugore, të trafikut dhe të kontrollit e definojnë kapacitetin, dhe nëse ndryshon ndonjëri prej tyre, atëherë ndryshon edhe kapaciteti. Kapaciteti i automjeteve matet me njësinë automjete në orë (aut/h).

Për llogaritjen e kapacitetit janë marrë në konsideratë elementet gjeometrike të rrugës dhe të qarkullimit, si:

- Numri i shiritave,
- Kategorizimi i rrugëve në tërë rrjetin dhe zhvillimi anësorë i saj,
- Gjerësia e shiritit,
- Shpejtësia e projektimit,
- Mundësia e shiritave të veçantë për kthime në kryqëzime.
- Shkalla e motorizimit
- Struktura e qarkullimit

Duke u bazuar në elementet gjeometrike të rrugëve dhe rekomandimeve nga (HCM-2000), është caktuar kapaciteti potencial për rrugën kryesore dhe ato dytësore si në vijim:

$C=400-500$  (aut/h që krahasuar me raportin  $q/C = 341/450 = 0,75$  që i përgjigjet niveli të shërbimit  $D$  (nivel afër shkallës së ngopjes, ku raporti  $q/C = 0,7-0,8$ ), dhe gjatë këtij niveli gjithashtu, është e mundur zhvillimi i qarkullimit në kushte normale.





Shkaqet e mbingarkimit të trafikut janë në përgjithësi pamjaftueshmëria e kapacitetit të kryqëzimeve, të cilat paraqesin pikat konfliktuozë në hyrje të kryqëzimeve.

Për këtë është e nevojshme të vlerësohet kapaciteti i kryqëzimeve për situatën ekzistuese dhe pastaj të bëhet krahasimi me flukset e parashikuara që rrjedhin nga zgjidhjet e variantit të propozuar.

Por, pas realizimit të variantit të propozuar, përmes sinjalizimit adekuat horizontal dhe vertikal mund të rregullohet qarkullimi i automjeteve, nëpërmjet përdorimit të kthimeve të ndaluara, të kalimeve në rrugë një drejtimeshe, posaqerisht në pjesën e rugeve, ku distanca në mes udhekryqeve apo kycjet pikeprehen me ruge të kategorive më të larta etj.

### **Përmirësimi i kushteve të qarkullimit**

(lëvizja dhe qëndrimi i automjeteve dhe këmbësorëve)

**Sigurimi i rrjedhshmërisë së qarkullimit të automjeteve sipas variantit të propozuar siguron shpejtësi më të rregullta dhe mesatarisht më të lartë se ato të qarkullimit aktual. Elementet gjeometrike të propozuara në rrugët primare pos tjerash mundësojnë edhe qarkullimin e automjeteve për transport urban (rekomandohet mjete të lehta (8+1)), duke realizuar një reduktim të përdorimit të automjeteve personale dhe duke siguruar avantazhe për të gjithë përdoruesit e rrjetit rrugor.**

Per të aplikuar shërbimin e transportit publik, paraprakisht duhet të bëhet një analizë nga organet kompetente, pasi që distancat e shkurtra për të arritur në kufirin e zonës nga kembësorët (rr. "Gazmend Zajmi" dhe "Isa Kastrati"), do të ishte me pershtatshme të orientohet qarkullimi i mjeteve të transportit publik (kriteri i ecjes këmbë 10 min deri në qasjen e parë të shërbimit të transportit publik).

Për më tepër, sigurimi i shpejtësive më të rritura dhe të një rregulli të qëndrueshëm në transportin në transportin urban sigurisht që çon në kërkesën për rritje të përdorimit të një shërbimi të tillë, duke siguruar në këtë mënyrë një element baze të mos mbingarkesës së trafikut urban, duke pasur parasysh kapacitetin më të lartë të mjeteve të transportit kolektiv në krahasim me ato të transportit individual.

### **Organizimi i parkingjeve**

Sigurimi dhe rrjedhshmëria e trafikut në rrugët rrjedhëse arrihet nëpërmjet ndarjes fizike të lëvizjes së mjeteve nga parkimi, duke evituar kështu mbivendosjen e funksioneve në të njëjtën shirit të lëvizjes normale të mjeteve dhe të manovrimit të hyrjes dhe të daljes nga parkimi.

Lëvizja dhe parkimi pa ndarje fizike lejohet në ruge të kategorive më të ulta, që i përgjigjet variantit të propozuar edhe atë:

Me organizimin e parkingjeve paralele në njërin anë përgjatë rrugës, krijohet mundësia e parkimit të rreth 1500 automjeteve, që është numër optimal për një lagje që është e destinuar për zonë banimi.

Duke i shtuar edhe vendet e parapara të parkimeve nëntokësore si dhe kushtëzimet nga organet kompetente gjatë ndërtimeve, që parkimi të sigurohet për çdo familje jashtë zonës së rrugës, mund të shpresohet në përmbushjen e kërkesave për parkim për këtë lagje.

Shiriti i dedikuar për parkim, në të cilin vendet e parkimit duhet të tregohen me anë të sinjalizimit përkatës me gjerësi: 2,00 m për parkim.

### **Transporti Publik**

Përgjatë lagjes së Muhaxhirëve nuk qarkullon asnjë prej linjave të transportit publik urban. Për këtë arsye edhe më tepër vë në shprehje shërbimi me Taxi si një nga format e transportit të udhëtarëve.

Shërbimi i transportit Publik duhet të jetë prezent në rrugët e skajshme të lagjes, e shprehur në distancë është afërsisht 300 m. Shfrytëzuesi i shërbimeve të transportit publik nga kjo lagje, brenda limitit të lejuar ka qasje në këtë shërbim edhe pse gjindet jashtë zonës (ecje në këmbë 10 min deri në stacionin më të afërt të transportit publik).

Transporti publik të realizohet përmes rugeve: "Isa Kastrati", "Gazmend Zajmi" e që ndërlidhen me rrugën e zonës qender "Agim Ramadani".

Vendndalimet e mjeteve të transportit publik të vendosen në raport me kërkesën për transport, duke respektuar distancën minimale në mes vendqendrimeve prej 300 m.

Vendndalimet mund të vendosen:

- Në shiritin e qarkullimit përmes sinjalizimit adekuat, ose
- Zgjerimit të shiritit jashtë sipërfaqes qarkulluese duke respektuar dimensionet.

## Qasja në rrugë nga blloqet e banimit

Qasja në rrugë nga blloqet e banimeve të organizohet në forme të tilla që qasja të mos të bëhet në rrugët kryesore (Gazmend Zajmi, Agim Ramadani dhe Isa Kastrati), por në rrugët brenda lagjes (ilustrimi). Kycja në rrugë nga blloqet, të bëhet minimalisht në distance prej 35 m nga udhëkryqet (në raste se nuk paraqitet distance e mjaftueshme, atëherë të realizohet kycja në mes udhëkryqeve).




fig. 40. Qasjet në blloqe

## Rrezet e rumbullaksimit.

Me qëllim të racionalizimit të hapësirës, në udhëkryqe janë përdorur rrezet e rumbullaksimit me rreze prej 5m, që në aspektin teknik janë të mjaftueshme për të mundësuar kthimet e mjeteve gjate ndërrimit të drejtimit. Shpejtesia maksimale e lejuar për levizje të mjeteve në këto zone të aplikohet 40 km/h.

Rrezja e rumbullakimit në udhëkryqe varësisht nga lloji i automjeteve

Lloji i automjetit	R (min)
Automjetet e udhëtarëve	6
Kamionët dhe autobusët	10
Kamionët me rimorkio	12
Autobusët urban me kapacitet të madh bartës	15

Marrë në përgjithësi, në hapësirat urbane nuk është e domosdoshme (as e dëshiruar) që të mundësohet tejkalimi ndërmjet udhëkryqeve të njëpasnjëshme me dy shirita. Në disa raste, distancat e dëshiruara ndërmjet udhëkryqeve, të cilat rrjedhin nga kërkesat teknike të komunikacionit, mund të vendosen vetëm në rast të koordinimit të pajisjeve me sinjalizim ndriçues, kjo distancë nënkupton distancën e nevojshme për pritje dhe atë për ndërrimin e shiritit.

## Pjerrtësia gjatësore

Pjerrtësia gjatësore maksimale nuk duhet të kalojë vlerën prej 12% (rrugë të karakterit më të ulët). Në rastet ku terreni paraqitet me pjerrtësi mbi këto vlera, atëherë gjate projektit kryesor të rrugës të ulët kjo pjerrtësi duke aplikuar gërmim/ mbushje varësisht nga konfiguracioni i terrenit.

Pjerrtësia e lejuar varësisht nga kategoria e rrugës dhe lloji i terrenit

Lloji i rrugës	Pjerrtësia e lejuar (%)			
	I rrafshët	Pjesërisht kodrinor	Kodrinor	Kodrinor-malor
Autorruga	-	4-5	5	7
Rruga e rangut I-rë	-	5	6	7
Rruga e rangut II-të	-	6	7	8
Rruga e rangut III-të	-	7	8	10
Rruga e rangut IV-të	-	8	10	11
Rruga e rangut V-të	-	10	11	12

## Devijimi i aksit

Në rastet kur hapësira për vendosjen e udhëkryqeve është e kufizuar, si dhe shpejtesia e parapare për levizje (projektuese) është e vogël (jo më e madhe se 40km/h), mund të aplikohet devijimi i aksit apo prejerje e akseve në kënd jo të drejtë. Në aspektin e zgjidhjeve teknike, devijimi i aksit nga njëra anë e udhëkryqit, nuk paraqet ndonjë efekt negativ në sigurinë e qarkullimit, përveçse rritje kohën e udhëtimit në udhëkryq në rastet e kthimeve majtas. Në çeshtje praktike, si zgjidhje e racionalizimit të hapësirës apo ruajtjes së tarsës ekzistuese (në rastin tone) devijimi i aksit në anet e ndryshme të udhëkryqeve paraqitet si opsion për aplikim.

## Pjerrtësia e lejuar e parkimeve

Pjerrtësia gjatësore e lejuar për parkim limitohet në raport me kufizimet teknike të mjeteve në aplikim të mekanizmit për parkim (freni i parkimit). Pjerrtësia maksimale e lejuar njëherë është pjerrtësi të cilën e mbizoteron freni i parkimi apo ndihmes gjate aplikimit.



Ne rastin konkret pjerrtesia gjatesore maksimale lejuar per parkim eshte paraqitur ne tbelen vijuese.

Nga literatura profesionale, lidhur me performancën e sistemit të frenimit me rastin e parkimit në pjerrtësi, efikasiteti i frenit të dorës duhet të siguroj ndaljen e automjetit gjatë parkimit duke plotësuar kriteret si në vijim:

- për të gjitha automjetet motorike deri në 20% (për tatëpjetë dhe teposhtë),
- për mjetet kyçëse deri në 18%, ndërsa
- për mjetet motorike të cilat tërheqin rimorkio deri në 12%.

## 12 SISTEMI I UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

### Përshkrimi teknik për zgjidhjen urbane për lagjen e Muhaxhirëve Ujësjesli dhe Kanalizimi

#### Lokacioni: Prishtina

Prishtina është në verilindje të pjesës qendrore të Kosovës. Është në lartësinë mbidetare 600,00 deri 700,00 m, ndodhet në pellgun e lumit Sitnica.

Qyteti ka afër 500 000 banorë. Sipas planifikimeve që janë punuar në vitet e '80, ky qytet në vitin 2000 duhej të kishte 320 000 banorë (baza për hidroekonomi 1982).

Shtimi i shpejtë i popullatës është si pasojë e luftës së vitit 1999, ku u bë migrim i pakontrolluar i popullatës. I njëjti fenomen vërehet dhe në qytetet tjera.

#### Kushtet gjeologjike

Prishtina është pranë pellgut të lumit të Sitnicës. Rrethina e këtij qyteti ka përbërje gjeologjike tokë e zeze, e kuqe e përzier me zallë dhe qymyr.

#### Kushtet hidrologjike dhe meteorologjike

Matja e nivelit (rrjedhja) e lumit të Sitnicës bëhet në vendin Nedakovc në largësi prej 26 km nga Prishtina.

Shënimet e rrjedhjes së lumit Sitnica i takojnë periudhës 1957 – 1986 (29 vite)

Të reshurat , temperatura janë shenuar në stacionin hidrometeorologjik të Prishtinës. Shënimet janë për periudhën kohore 1926 – 1988

Të reshurat mesatare mujore dhe vjetore

Muajtë	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	totale
H (mm)	35	35	33	49	73	58	47	43	48	54	62	50	588




fig. 41. Temperatura mesatare e ajrit mujore dhe vjetore

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t °C	-1.2	0.9	5.7	9.9	14.6	17.9	19.9	19.8	16.0	10.5	5.3	0.9	10.0




fig. 42. Rrjedhja e lumit Sitnica në Nedakovc

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Rrjedhja	17.87	25.80	24.79	20.08	16.31	8.10	3.69	2.12	3.08	5.71	11.04	16.32



## LAGJA E MUHAXHIRËVE

Plani rregullues Urban për zonën “Muhaxhirët” përfshinë një sipërfaqe prej **61 ha**, dhe shtrihet në pjesën lindore të qytetit të Prishtinës, kjo lagje kufizohet me zonën e urbanizuar Dodonën, Velaninë dhe Sofalinë, në lindje dhe jug-lindje me zonën e urbanizuar Matin, ndërsa në jug me Bregun e Diellit, pjesën perëndimore e kufizon rruga Agim Ramadani me Qendrën 2.

Kjo lagje ndodhet në lartësinë mbi detare 603-682m.

## LLOGARITJA E SHPENZIMEVE TË UJIT PËR LAGJEN E MUHAXHIRËVE

### Koncepti i furnizimit me ujë dhe sasi të nevojshme

Duke u bazuar në destinimin e sipërfaqeve sipas planit të propozuar dhe numrit të banorëve është llogaritur sasia e nevojshme e ujit për blloqet urbane që janë paraqitur në tabelën.

Rekapitullimi i ujësjellësit			
Tërsia Urbane	Bloku	Q <sub>max.ores</sub> Q <sub>max.h</sub>	Q <sub>mes.orare</sub> Q <sub>av.h</sub>
Tërsia e Blloqeve		(l/sec)	(l/sec)
	A	11.70	5.85
	B	69.22	34.61
	C	20.59	10.29
	D	3.92	1.96
	E	8.03	4.02
	<b>Totali</b>	<b>105.43</b>	<b>56.73</b>

Llogaritja e shpenzimeve të ujit deri 13,500 banor

Tabela nr.1

Sasia mesatare e nevojshme e ujit për këtë lagje për 13,500 është  $Q_{mes.o}=56.73$  (l/sec), ndërsa për dimensionim të gypave është sasia maksimale orare  $Q_{max.or}=105.43$  (l/sec) me koeficienta jouniformiteti  $k_{o.1}=1.2$  dhe  $k_{o.2}=1.2$  dhe me normën e hargjimit të llogaritur për kokë banori  $q=150$  (l/banorë/ditë), ndërsa përqindja e pjesëmarrjes për nevoja ekonomiko-publike është marr 30% me koeficient për 1000 m<sup>2</sup> prej (0.10-0.15) l/sec.

Rekapitullimi i ujësjellësit			
Tërsia Urbane	Bloku	Q <sub>max.ores</sub> Q <sub>max.h</sub>	Q <sub>mes.orare</sub> Q <sub>av.h</sub>
Tërsia e Blloqeve		(l/sec)	(l/sec)
	A	15.55	7.77
	B	99.76	49.88
	C	20.59	10.29
	D	3.92	1.96
	E	8.03	4.02
	<b>Totali</b>	<b>139.81</b>	<b>73.92</b>

Llogaritja e shpenzimeve të ujit deri 28,000 banor

Rekapitullimi i ujësjellësit			
Tërsia Urbane	Bloku	Q <sub>max.ores</sub> Q <sub>max.h</sub>	Q <sub>mes.orare</sub> Q <sub>av.h</sub>
Tërsia e Blloqeve		(l/sec)	(l/sec)
	A	18.69	9.34
	B	109.94	54.97
	C	20.59	10.29
	D	3.92	1.96
	E	8.03	4.02
	<b>Totali</b>	<b>153.13</b>	<b>80.58</b>

Llogaritja e shpenzimeve të ujit deri 33,500 banor

Duke u bazuar në të dhënat nga Kompania Ujësjells Rajonal (KUR) “Prishtina” sasi të tanishme të ujërave, me të cilat furnizohet kjo lagje nuk do të mjaftojnë për furnizim me ujë edhe në të ardhmen.

Furnizimi me ujë do të përmirsohet në këtë lagje pasi që do të ndërtohet gypi (Ø1000 mm) nga rezervuari në Arbëria (ish-Dragodan) deri në stacionin e pompave te parku I qytetit, pastaj një pjesë e lagjes furnizohet me anë të pompave kurse pjesa tjetër do të furnizohet nga rezervuari I cili ndodhet afër lagjes së Muhaxhirëve, rezervuari (Mirdita II).



Koncepti i furnizimit me ujë në të ardhëm do të orientohen në sistemin qendror të ujësjellësit d.m.th. nga KUR "Prishtina" përmes fabrikës së re për përpunimin e ujit të pijes që është paraparë të jetë në fshatin Shkabaj. Nga kjo fabrikë uji do të transportohet në rezervuarin në kodër në Shkabaj që është me kapacitete  $V=20.000 \text{ m}^3$  e që do të mbulonte pa problem këtë lagje.

#### Sistemi shpërndarës i rrjetit dhe objektet tjera ne sistem

Infrastruktura e gypave duhet të vendoset kryesisht nëpër trotuare ose në rrugë sipas rradhitjes së instalimeve tjera, kryesisht shpërndarja e rrjetit të ujësjellësit është rrjet unazor. Diametrat e gypave do të jenë nga gypat primar me madhësi deri në  $D=450\text{mm}$  dhe rrjeti shpërndarës ose sekondar i blloqeve dhe rrjetit të hidrantëve  $\varnothing 110 \text{ mm}$ .

Materilati i gypave duhet të jetë HDPE-100 ose GRP.

Është paraparë të behet ndrimi i rrjetit ekzistues përshkak të vjetërsisë së gypave të cilët kryesisht janë AC, në përjashtim të disa gypave të cilët janë të ndërruar në kohët e fundit PE dhe GRP dhe disa janë duke u punuar.

Vendosja e gypave është paraparë te jetë sa më afër shfrytëzuesve dhe të ketë presion të mjaftueshëm në çdo pikë.

Lagjja do të furnizohet me ujë me ramje të lirë pra me presion të krijuar nga gravitacioni.

#### SISTEMI I KANALIZIMIT

##### Koncepti i largimit të ujërave fekale dhe atmosferike

Sistemi i kanalizimit të ujërave fekale dhe atyre atmosferik parashihet të jetë sistem i ndar, ujërat sanitare të jenë plotësisht të ndara nga ujërat atmosferike, është paraparë që në të gjithë infrastrukturën rrugore të tërhiqen trasat për dy rrjetet të ndara veç e veç njëra për ujëra atmosferike e tjetra për ujëra sanitare.

Materiali i gypave që parashihet të përdoren duhet të jet nga materiali HDPE-100, sipas standartit prEn13476 (DIN 16961) dhe ISO 9969.

Pozita gjeografike e lagjes së Muhaxhirëve mundëson që largimi i ujërave të zeza të bëhet në mënyrë gravitacionale dhe ky koncept në këtë plan parasheh që tërë sasia e ujit të largohet në këtë mënyrë.

Sasitë e llogaritura për tërësitë urbane të blloqeve janë paraqitur në tab 2.:

Tërësia Urbane	Bloku	Qmax.orare (l/sec)	Q mes.orare (l/sec)	Ujerat atmosferike (l/sec)
Tërësia e Blloqeve	A	12.76	6.35	201.45
	B	80.30	39.95	3,420.74
	C	23.16	11.52	831.50
	D	11.75	5.84	687.82
	E	9.27	4.61	562.24
	<b>TOTALI</b>	<b>127.97</b>	<b>63.66</b>	<b>5,141.51</b>

**Llogaritja e sasis së ujërave fekale dhe atmsofeirk deri 13,500 banor**

Tërësia Urbane	Bloku	Qmax.orare (l/sec)	Q mes.orare (l/sec)	Ujerat atmosferike (l/sec)
Tërësia e Blloqeve	A	16.45	8.18	201.45
	B	116.14	57.78	3,420.74
	C	23.16	11.52	831.50
	D	11.75	5.84	687.82
	E	9.27	4.61	562.24
	<b>TOTALI</b>	<b>167.49</b>	<b>83.33</b>	<b>5,141.51</b>

**Llogaritja e sasis së ujërave fekale dhe atmsofeirk deri 28,000 banor**



Tërësia Urbane	Bloku	Q <sub>max.orare</sub>	Q <sub>mes.orare</sub>	Ujerat atmosferike
		(l/sec)	(l/sec)	(l/sec)
Tërësia e Bbloqeve	<b>A</b>	19.43	9.67	201.45
	<b>B</b>	128.08	63.72	3,420.74
	<b>C</b>	23.16	11.52	831.50
	<b>D</b>	11.75	5.84	687.82
	<b>E</b>	9.27	4.61	562.24
	<b>TOTALI</b>	<b>182.42</b>	<b>90.76</b>	<b>5,141.51</b>

Llogaritja e sasis së ujërave fekale dhe atmosferike deri 33,500 banor

#### Kanalizimi fekal

Kanalizimi fekal është llogaritur për 4 tërësitë urbane dhe norma për banor është marrë  $q=150$  l/ban/dite, ndërsa sasia totale duke përfshirë amvisërinë dhe joamvisërinë e ujërave të zeza për orën max. për 13,500 banor është  $Q_{max.or}=127.97/sec$ .

#### Koncepti i largimit të ujërave fekale (sanitare)

Largimi i ujërave fekale është parapare të bëhet me rënje gravitacionale, ndërsa rrjeti primar është paraparë të shkoj paralel nëpër rrugë ku do të ishte e mundshme qasja më e lehtë e lidhjes së blloqeve.

Ujërat e zeza të kësaj lagjeje duke u bashkuar me ujërat tjera fekale të qytetit të Prishtinës do të shkarkohen në impiantin për pastrimin e ujërave të zeza që do të ndërtohet në Fushë Kosovë mbrapa statcionit të Hekurudhës.

#### Kanalizimi atmosferik

Kanalizimi atmosferik është llogaritur për gjashtë njësitë urbane duke e ndarë në gjashtë pellgje ku maksimum mund të tubohen rreth  $5.14$  m<sup>3</sup>/sec për të tërë territorin e Muhaxherve të paraqitur në tab. 2.

#### Koncepti i largimit të ujërave atmosferik

Largimi i ujit atmosferik është konceptuar përmes ndërtimit të kolektorëve atmosferik që do të përfshinin grumbullimin e ujit të shiut nga objektet, rrugët dhe pjesët e gjelbëruara.



## 13 STEMI I NGROHJES

Zhvillimi dhe ndërtimi i objekteve të banimit, lokaleve afariste, shkollave e objekteve tjera që do të mbizotërojnë në vitet e ardhshme dhe do të rezultojë me rritje të vazhdueshme të kërkesave për konsum termik e që do të paraqesin edhe bazën për planifikimin, projektimin dhe zhvillimin e një furnizimi qendror me energji termike.

Prandaj përmbushjen e kërkesave me energji termike për objekte banimi, lokale afariste edhe për nevojat tjera, duhet të realizohet në mënyrë kontinuale, të sigurtë dhe me një kosto ekonomike.

Konsumatorët termik bashkë me rrjetin dhe burimin e energjisë termike përbëjnë sistemin termik. Ky sistem termik patjetër përcillet edhe me pajisjet tjera ndihmëse, siç janë sistemet e rregullimit e që kanë për qëllim për të siguruar punën normale të impianteve dhe rrjetit, për rastet e ndryshme të ngarkesës termike.

Ngrohja në largësi është mënyra e përfitimit të energjisë me anë të së cilës uji ngrohët në një vend qendror dhe përmes rrjetit shpërndarës shpërndahet deri te konsumatori për shfrytëzim.

Ngrohja në largësi përbëhet nga pjesët themelore si vijon:

1. Ngrohtorja – kaldajat , flakëhedhësit, oxhaku , rezervuari i lëndës djegëse , përgatitësin e ujit sanitar paisjet dhe aparatet tjera matëse dhe rreguluese dhe të gjitha elementet tjera përcjellëse .
2. Rrjeti gypor për ngrohje në largësi – nga i cili ujin e ngroht apo të tejnxehur e dërgon në objekte të ndryshme.
3. Nënstacioni – nga i cili ngrohja ( nxehtësia ) nga rrjeti gypor primar i ngrohjes në largësi i jepet paisjeve të objekteve ( këmbyesve të nxehtësisë)
4. Rrjeti gypor i objekteve ( i brendshëm ) ose rrjeti sekondar i cili e shpërndan nxehtësinë në secilin trup ngrohës dhe shpenzus tjerë.

Për instalimin e ngrohjes qendrore në largësi është me rëndësi të shqyrtohet ekonomikiteti për secilin rast në mënyrë të veçant

Kujdes të veçant për zgjedhjen e këtij sistemi meritojnë faktorët në vijim :

- Dendësia e ngarkesës termike për rrethinën që do të ngrohet
- Dendësia për sipërfaqe – MW/ km<sup>2</sup> dhe dendësia për gjatësi MW/km
- Shpenzimet për furnizim me nxehtësi
- Struktura e rajonit që duhet të ngrohet
- Mundësia për paisje të ngrohtorës
- Intenziteti i transportit të lëndës djegëse dhe hirit
- Lirimi i materijeve të rrezikshme si SO<sub>2</sub> ,pluhuri ,hiri etj.
- Vlerat e lejuara të emetimit
- Ngarkesa ndaj zhurmës apo intensiteti i zhurmës

Zgjedhja e paramtrave në sistemin e ngrohjes në largësi :

- Temperatura e e gypit të furnizimit dhe atij e kthimit ;
- Presioni dhe temperatura e avullit ( shfrytëzimi i nxehtësisë);
- Veprimi i ngarkesave ;
- Shfrytëzimi vjetor në orë.

Koncepti i rrjetit gypor dhe shtrirja e rrjetit :

- Në kanal pa kanal , afat shërbimi ( vetitë e tokës);
- Përfitimi i sigurt;
- Rrjeti gypor adekuat;
- Ujrat nëntoksor dhe sipërfaqësore dhe ujrat buz lumnjeve dhe detit;
- Lloji i tokës.

Përparësit e ngrohjes në largësi

- Nuk ka transportim të lëndës djegëse dhe hirit për në objekt nga ai;
- Mundësia e shfrytëzimit të lëndës djegëse të lirë si psh. Mbeturinat dhe qymyri i hudhur;
- Ekonomizimi i madh në shfrytëzimin e lëndës djegëse;
- Siguria më e madhe e përdorimit , kapaciteti të pandërprerë të më shumë kaldajave;
- Kursimi i hapsirës , nuk ka kaldatore , as vend për lënd djegëse as për oxhak në objektet që ngrohen;
- Mirëmbajtje e lehtësuar, siguri e madhe kundër zjarrit;
- Më pak ndotje të ambientit nga SO<sub>2</sub> dhe tymit ;
- Zvoglimit të lirit të CO<sub>2</sub>.

Ndarja e sistemeve të ngrohjes në largësi :

Sipas bartësit të nxehtësisë (mediumit punes) ndahen në:

- Ngrohja me ujë të ngrohtë me temperaturatë deri në 110°C
- Ngrohja me ujë të ngrohtë me temperatur mbi 110°C
- Ngrohja me avull

Përparësit e ngrohjes në largësi me ujë të tejnxehur:

- Nuk ka kondenzat e me këtë ska humbje përkatëse;
- Përdorimi i gypave të lirë nga materiali sintetik;
- Rrjeti gypor i thjeshtë;
- Gjatë ndryshimit të madh të temperaturës bëhet edhe transportimi i madh i nxehtësisë në rrjet;
- Zvoglimi i humbjeve të nxehtësisë gjatë transportit të nxehtësisë në rrjetë
- Lehtësimi i mirmbajtjes;
- Afatshërbim i gjatë i përdorimit.

Ngrohja në largësi me ujë të tejnxehur ka përdorim të gjerë sidomos në ngrorjen e qyteteve tek të cilët përveq ngrohjes qendrore të zkonshme bëhet edhe furnizimi me ujë sanitar (psh. Spitale, fabrika etj.)

Në funksion të temperaturës së jashtme (prej  $-17^{\circ}\text{C}$  deri  $-12^{\circ}\text{C}$ ), bëhet përzierja e ujit të tejnxehur në hyrje ( $140^{\circ}\text{C}$  deri  $52^{\circ}\text{C}$ ), temperatura projektuese, dhe në dalje (prej  $80^{\circ}\text{C}$  deri  $36^{\circ}\text{C}$ ) nga rrjeta e qytetit.

Gjatë temperaturës minimale  $-17^{\circ}\text{C}$ , temperatura e ujit të tejnxehur është  $140^{\circ}\text{C}$ , temperatura projektuese, ndërsa në dalje  $80^{\circ}\text{C}$ .

Rrjetet termike, duhet t'i përgjigjen kërkesave të konsumatorëve në sasi dhe cilësi, dmth. mbartësi i nxehtësisë kur të arrijë tek konsumatori duhet të ketë parametrat dhe sasinë e kërkuar.

Rrjeti termik përmban:

- sistemin primar  $140/80^{\circ}\text{C}$
- sistemin sekondar  $90/70^{\circ}\text{C}$

Në sistemin primar, uji i tejnxehur  $140/80$ , nga ngrorja me gypa të paraizoluar, dërgohet në nënstationin termik të objektit, ku me anë të këmbyesit të nxehtësisë bëhet transmetimi i nxehtësisë në sistemin sekondar.

Në sistemin sekondar, uji i ngrorë  $90/70^{\circ}\text{C}$ , bën transmetimin e nxehtësisë deri te trupat ngrohës (radiatorët).

Dimensionimi i tubacioneve është bërë në bazë të sasisë së nxehtësisë, për çdo objekt, me parametra të ujit primar  $140/80^{\circ}\text{C}$

Kalkulimet e fituara, për kompleksin e objekteve përkatës, sipas vizatimeve të marrura nga arkitektura për tërësitë janë:

tërësia A .....	12.34 MW
tërësia B .....	40.77 MW
tërësia C.....	5.076 MW
tërësia D.....	9.49 MW
tërësia E.....	5.89 MW

Gjithsej: **73.58 MW**

Pra siç shihet, për ngrohje në largësi, të lagjes Muhaxher kërkohet një kapacitet ngrohës  $73.58\text{ MW}$ .

Stacioni i ngrohjes ose ngrorja e re për zonën Muhaxher me kapacitet përkatës është dhënë si ide në vizatimin e prezentuar.

Propozohet një kaldatore me dy kaldaja me kapacitet  $Q = 50\text{ MW}$ , ku njëra do të punojë vazhdimisht kurse tjetra të jetë rezervë dhe parashihet të punoj vetëm për kushtet ekstreme të temperaturave të jashtme.

Për shkak të kursimit përdoren tubat e paraizoluar, pa patur nevojë për punimin e kanaleve të betonit, pra tubat e paraizoluar vendosen në toke dhe si të fillë i rezistojnë kushteve të veshitja, posaçërisht në pikepamje të paraqitjes së rrezikut nga korozioni. Kështu që para se të zgjidhet tubacioni, duhet patur parasysh që ti plotesoje kushtet e fortësisë, izolimit, mbrojtjes nga lagështia, korozioni etj.



fig. 43. gypat ISO plus

Këto tubacione përdoren për transportuar bartësin e nxehtësisë (ujin ose avullin e ujit) prej ngrorës gjer te shpenzuesi.

Tubacionet e paraizoluara duhet të jenë të punuara nga shkuma e poliuretanit, e cila është e futur me presion në mes të tubit të çelikut dhe shtresës mbrojtëse të plastikes në pjesën e jashtme. Këto tubacione duhet të kenë atestet e kualitetit të materialit dhe të jenë standardizuara, pra t'i plotesoje normat dhe standardet e bashkësisë europiane.

Pozita e tubacioneve është në koten  $H = -1.00\text{ m}$ , çka perfundi rruges nuk paraqitet rrezik nga shembja e dheut dhe vibracionet e mundshme nga komunikacioni rrugor, sepse janë marre parasysh ngarkesat e tokës dhe tubacioneve percjellese përgjatë rruges.

Rrjeti gypor vendoset në kanal in e hapur në form trapezi ku së pari shtrohet një shtresë me trashësi  $100-150\text{ mm}$  me rërë të imët mbi të cilën vendosen gypat dhe mbulohen poashtu me rërë të imët  $100-150\text{ mm}$  mbi gypat e paraizoluar.





Mbi rërën e imët vendoset dheu paë përmbajtje të gurëve të mprehtë. Distanca mes gypave është sa diametri i njërit gyp.



fig. 44. Pozita e tubacioneve në kanal

Pusetat duhet që të ekzekutohen sipas standardeve dhe normativave në atë mënyrë që gjatë intervenimeve të mundshme, ekipa e mirëmbajtjes së magjistralit të ujit të ngrohte, pa pengesa të kryej punimet e mirëmbajtjes, apo zëvendësimet e armaturave të ndryshme. Pra pusetat në parim duhet të jenë të ekzekutuara si të kalueshme për armaturën dhe personelin. Për shkak të kushteve ekonomike dhe sigurisë së vetë sistemit magjistrat, duhet të aplikohen sa më pak pusetat dhe ato të lidhen si shumë funksionale në degëzimet dhe furnizimin e pjesëve të qytetit.

Mbi shtresën e dheut vendoset një shirit sinjalizues i cili duhet të jetë 300-400 mm nën sipërfaqen e tokës i cili shërben si paralajmërim gjatë gërmimeve të gypat gjenden nën të. Degëzimi i rrjetit gypor bëhet me ndihmën e elementeve të paraizoluara si kthesa 90°, 45°, T-pjesë, T-pjesë, reduktues, vazhduese, tapa etj.

Në shtresën e termoizolimit janë të vendosur telat sinjalizues të cilët në rast rrjedhjeje e aktivizojnë alarmin në ngrohtore.

Pusetat sipas funksionit parashihen për :

- Organe për mbyllje dhe pajisjet matëse
- Ç'ajrosje dhe zbrazje
- Kompensatore
- Hyrje në nenstacione termike të objekteve
- Kontroll të rrjetit
- Nderprerjen e ujit në raste të havarive të paraqitura



## 14 RRJETI ELEKTROENERGJETIK

### 14.1 GJENDJA AKTUALE

KEK (Korporata Energjetike e Kosovës) është përgjegjëse për prodhimin dhe distribuimin e energjisë elektrike në Kosovë. Pjesa më e madhe e energjisë elektrike është e prodhuar nga dy centrale të mëdha elektrike në Kastriot, në perëndim të Prishtinës. Në mungesë të mirëmbajtjes, ngjarjeve të luftës dhe problemeve teknike, prodhimi është reduktuar nën kapacitetin nominal. Edhe pse energjia elektrike shtese importohet, furnizimi 24 orësh me energji elektrike nuk mund të sigurohet. Zona urbane e Prishtinës, duke përfshirë tërë hapësirën e planit urban rregullativ furnizimi me energji elektrike bëhet kryesisht nga linjat mbikësore. Për shkak të problemeve me prodhim, përdorimi i gjeneratorëve është mjaft i shpeshtë.

Në aspektin e mirëmbajtjes së rrjetit si dhe furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike, i tërë konsumi i energjisë elektrike në lagjen e Muhaxhirëve në nivelin distributiv, menaxhohet dhe eksploatohet nga Distrikti i Prishtinës. Në aspektin e planifikimit të zgjerimit të rrjetit distributiv kjo njësi participon vetëm me shënimet nga terreni. Poashtu implementimin e projekteve të reja, kjo njësi punon vetëm e garanton nga aspekti i sigurisë elektrike, si dhe merr pjesë në pranimet teknike të objekteve të reja për nivelin distributiv.

Lagjja e Muhaxhirëve furnizohet nga trafostacioni TS Prishtina 2 110/10 kV/kV me fuqi instaluese 2x31.5 MVA dhe TS Prishtina 6(III) 35/10 kV/kV. Që të dy këto trafostacione furnizohet përmes linjave 110 kV, konkretisht linjës nga TS Prishtina 5 dhe TS Prishtina 4. Vlen të potencohet se siguria furnizuese në nivelin 110 kV relativisht është e kënaqshme, nga shkak se rënja e njëres nga linjat 110 kV nuk shkakton pamundësinë e furnizimit kontinuel të Lagjes, pra plotësohet kriteri shumë i nevojshëm N-1.

### 14.2 RRJETI I TENSIONIT TË MESËM (RRJETI 10kV)

Në nivelin e tensionit të mesëm shumica e objekteve të instaluar elektroenergjetike janë për tension 10 kV. Linjat furnizuese të tensionit të mesëm të instaluar para vitit 1999 janë të dimensionuara kryesisht për nivelin 10 kV. Vetëm disa kanalizime kablove të instaluar pas luftës janë të parapara për punë nën tension 20kV.

Ekziston një pjesë e linjave ajrore të montuara në shtylla të impregnuara të drurit (SHD), në shtylla të betonit (SHB), e në disa ekziston kombinim i tyre (SHBD). Në disa nga trasat e linjave 10 kV dhe 0.4 kV, me shtylla të drurit, lartësia e pëçuesve el. është e ulët, distanca me objektet e banimit, afariste dhe shoqërore e pamjaftueshme, kalimet në rrugë janë joadekuate, kështu që nuk i përmbushin kriteret nga aspekti i sigurisë.

Njësitë transformuese janë të tipit "blindë" TSMB. Gjendja teknike e këtyre objekteve në tërësi nuk është e mirë, nga fakti se shumica e tyre janë të vjetërsuara

dhe jo të mirëmbajtura si duhet. Edhe këtu një pjesë e konsiderueshme e objekteve transformuese nuk posedojnë pajisje teknike në rregull, kështu që paraqesin rrezik për stafin operativ të mirëmbajtjes, e veqënisht për sigurinë e qytetarëve.

Mund të konstatohet se krijimi i rrjetit shpërndarës furnizues këtu është realizuar pa ndonjë analizë, sidomos në aspektin e optimizimit. Problem poashtu të theksuar paraqesin seksionet jo adekuate të përqesve të linjave 10 kV-she në raport me gjatësitë e tyre dhe numrin e TS-ve të kyqura në to.

### 14.3 RRJETI I TENSIONIT TË ULËT (RRJETI 0.4kV)

Furnizimi elektrik sigurohet nga trafostacionet ekzistuese 10/0.4kV ose 20/0.4kV. Rrjeti i tensionit të ulët deri të konsumatorët (shtëpitë individuale, objektet banesore individuale e shoqërore, objektet tjera të afarizmit) është realizuar kryesisht me përqesit ajrorë mbi shtylla druri të cilat duhet ndërruar apo zavendësuar me shtylla të reja.

Rrjeti ekzistues është përshtatur nevojave aktuale, por në të gjitha zgjidhjet teknike të ardhshme duhet të përfshihen planet e zhvillimit dhe zgjerimet e linjave furnizuese të rrjetit elektroenergjetik për tërë territorin e përfshirë, me ç'rast furnizimin elektrik në zonat me dendësi të madhe banimi duhet paraparë kryesisht me kablo nëntokësorë me përjashtim të rasteve të veqanta ku diktohet edhe nevoja e kyqjes ajrore në rrjetë.

Kyqja e konsumatorëve (objekteve) në rrjetin e tensionit të ulët realizohet nga kuadrat e kyqjes kryesore elektrike të vendosur në pjesën e jashtme të objektit. Në kuadër vendosën tri siguresat shkrirëse të dimenzionit përkatës. Kuadri është i mbyllur dhe në të ka qasje vetëm personeli i shërbimit të autorizuar nga korporata e distribucionit elektrik Rrjeti ekzistues sekondar 0.4kV që është nën mbikqyrje të korporatës elektrike distributive nuk është objekt përpunimi i këtij plani.

### NDRIÇIMI PUBLIK

Ndriçimi publik i rrugëve, shesheve dhe parkingjeve është realizuar me llambat me Zhive të vendosura në shtyllat metalike, kur është fjala për disa nga rrugët kryesore, ndërsa në shtylla të drurit me tensionit të ulët, kur është fjala për rrugë periferike.

Ekzistojnë lokacione që nuk janë ndriçuar sa duhet apo edhe fare, në këto raste në projektin e veqant të ndriçimit publik duhet paraparë, përveq zgjerimit të rrjetit të ndriçimit edhe zavendësimin e llambave të zhivës, me llamba me avuj natriumi ose edhe me trupat ndriçues të teknologjive të fundit, (p.sh. armaturat me LED .etj.), e kjo me qëllim të kursimit të energjisë.

Furnizimi i qarqve të ndriçimit duhet të realizohet përmes kablove nëntokësorë të tipit XP 41 A të seksionit prej 6 deri në 35 mm<sup>2</sup>. Është paraparë të ndriçohen të gjitha rrugët dhe trotualet. Tipi ,lartësia, shpërndarja dhe zgjedhja e trupave ndriçues do të përcaktohen me projektin e veqant për ndriçimin publik.

Furnizimi dhe komandimi i ndriçimit publik , do të ekzekutohet prej kuadrove të veqant të furnizuar nga trafostacionet më të afërt.

#### 14.4 RRJETET E TELEKOMUNIKACIONIT

Sa i përket gjendja aktuale në infrastrukturën telekomunikative, pas lufte PTK ka shtrirë kanalizimin kablovik të ri të rrjetit telefonik, kryesisht brezit të rrugëve ekzistuese, i cili përmbushë plotësisht kërkesat momentale. Mirëpo ekzistojë edhe rrjete të telekomunikacionit me kabllim mbitokësorë nëpër LP e tensionit të ulët të KEK-ut të instaluar nga kompanitë IPKO dhe Kujtesa.

#### 14.5 Propozimet teknike elektro energjetike dhe e telekomit ne lagjen e Muhaxhirëve

Propozimet Teknike janë dhënë bazuar në procedurat bazike që aplikohen gjatë planifikimit zvillimor urban të një SEE, e që janë:

1. Mbledhja e shënimeve për rrjetin ekzistues
2. Analiza e rrjetit ekzistues
3. Ngarkesa aktuale dhe ajo e parashikuar
4. Planifikimi optimal i lokacionit, madhësisë dhe zonës së TS 20/0.4kV.
5. Planifikimi i rrjetit distributiv 20kV.
6. Planifikimi i rrjetit distributiv 230/400V.
7. Analizat e rrjedhes së fuqisë.
8. Analizat e rrymave të l.sh dhe
9. Analizat e besueshmërisë së SEE

Duke u nisur nga gjendja ekzistuese si dhe propozimeve arkitektonike, SEE distributiv dhe Sistemi Telekomunikues (SK) duhet të bëhet pothuajse tërësisht i ri dhe në përputhje me dy rekomandime të dhëna në vazhdim:

- **Rekomandimet e master planit për zhvillimin e sistemit distributiv të Kosovës deri më vitin 2015, që përfshinë:**
  - Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV
  - Kalimin nga rrjeti distributiv 10kV në rrjetin distributiv 20kV
  - Zëvendësimin e TS 10/0.4kV me ata 20/0.4kV
  - Zëvendësimin i Linjave Ajrore 230/400V me kablllo bistek apo edhe kablllo nëntokësorë.
- **Regulloret e IEC, IEEE dhe ANSI që për projekte të reja në vende urbane, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe ato të rrjetit telekomunikues të ndjekin të njëjtën trasë dhe të realizohen në të njëjtën kohë.**

Rekomandimet dhe rregulloret e lartëshënuara obligojnë që SEE dhe SK të realizohen ashtu që:

A. Në njëren anë të trotuarit, të rezervuar për këtë qëllim në thellësi mbi 80cm ndërtohet i ashtuquajtur "kanalizimi kablovik" – fig.41. Në të vendosen gypa PVC me diameter prej 150mm, që përforcohem me beton të klasës C12/15. Në këta gypa vendosen:




fig. 45. Prerja terthore e tubacionit kablovik

1. Linja e tensionit 10(20)kV me kablllo XHP 49A 240mm<sup>2</sup>. Me këtë bëhet furnizimi i trafostacioneve të blinduara me herës 10(20)/0.4kV dhe fuqi 630kVA dhe 1000kVA.
2. Linja e tensionit 400/231V me kablllo PP00 4x95mm<sup>2</sup>
3. Linja e tensionit 400/231V me kablllo PP00 4x25mm<sup>2</sup> ose 4x16mm<sup>2</sup> për furnizime të ndriçimit publik dhe banimeve individuale
4. Linja e kablllove të komunikimit (kablllo me fije optike).
5. Linja e kablllove UTP 4x0.75mm<sup>2</sup>.

B. Përgjat trasës së kanalizimit kablovik duhet ndërtuar puseta në dimensione dhe forma të ndryshme sipas rastiit.

Në trasa të linjave të shumëfishta ndërtohen shahta të kombinuara – rrymë dhe komunikim sipas fig.42. Këto shahta kanë thellësi së paku 1.8m dhe dimensione të brendëshme së paku 1.8mx1.2m. Shahta e përbashkët është e ndarë me muri betoni 20cm në atë për rrymë dhe në atë për komunikim dhe kanë hyrje (vrime) të ndara.

Shaktat për kryqëzime të linjave të tensionit të ulët dhe linjave komunikuese mund të ndërtohen si të ndara dhe mund të kenë edhe dimensione më të vogla ( por jo më të vogla se 1.2x1.2x1.2m)

Hyrja në shahta bëhet nëpër vrimën me formë katrore me dimensione së paku 60cm. Në kapak duhet shkruar për puseta rryme – ELEKTRIKA, ndërsa për ato të komunikimit – TELEKOM

Trafostacionet 20/0.4kV, do të vëndosen në bodrume të objekteve, prandaj duhet të jenë të pajisura me transformatorë të thatë – pa vaj.

ne objekte banimi dhe 20W/m<sup>2</sup> në parkingje (garazha). Fuqia e instaluar dhe lokacioni i trafostacioneve 20/0.4kV është dhënë në Situacion.

Trafostacionet 20/0.4kV; do të furnizohen me kablo XHP 49A 3x1x240mm<sup>2</sup>, që do të vendosen në kanalizim kablovik. Furnizimi i TS do te behet në sistemin unazorë ashtu që të funksionoj sistemi N-1.




fig. 46. Pusetat e kombinuara

Numri i TS-ve është caktuar i fillë që çdo m<sup>2</sup> i objekteve të ketë në disponim fuqinë elektrike në vlerë prej:

- |                           |                     |
|---------------------------|---------------------|
| 1. Lokale afariste        | 60 W/m <sup>2</sup> |
| Ndriçim                   | 20 W/m <sup>2</sup> |
| Pajisje të tjera          | 40 W/m <sup>2</sup> |
| 2. Objekte banimi         | 60 W/m <sup>2</sup> |
| 2. Sipërfaqe shërbyese    | 30 W/m <sup>2</sup> |
| 3. Garazha për parkim     | 20 W/m <sup>2</sup> |
| 4. Pajisje për klimatizim | 30 W/m <sup>2</sup> |

Bazuar në kërkesat e lartëshenuara, objekteve që do të ndërtohen në lagjen e Muhagjereve do të duhet t'i sigurohet energji prej 90W/m<sup>2</sup> në lokale afariste, 60W/m<sup>2</sup>



## 15 DEMOGRAFIA

### Hyrje

Duhet menduar se një pjesë e mirë e elementit shqiptar kosovar i ka rrënjët e tij në popullsinë e vjetër ilire-shqiptare që mbisundonte aty që prej antikitetit.

Sipas historianit çek, Konstantin Jireček, në vepren e tij "Historia e serbëve" shqiptarët në mesjetën e hershme kanë humbur shumë tokë nga serbët, por megjithatë ata janë një popull që nuk vdes. Nga këto dhe shkrime tjera bëhet e ditur që këto territore i kanë banuar shqiptarët që në mesjetë merreshin si një popull i vjetër me kulturë të lartë qytetare.

Me ndarjen e kishës krishterë më 1054 në Kishën ortodokse të lindjes dhe në Kishën katolike të perëndimit, një pjesë e shqiptarëve të Kosovës lindore, që nga Kaçaniku deri në Mitrovicë, kanë qenë kryesisht ortodoksë, nën ndikimin e shtetit Bizantin ortodoks, kurse pjesa tjetër e shqiptarëve të Kosovës kanë qenë kryesisht katolik, nën ndikimin e Romës dhe Venedikut.

Shqiptarët në Kosovë përmenden edhe në dokumente (krisobula) kishtarë-shtetërore serbe në kohën e sundimit të Nemanjiqëve në shek. XIV, sidomos fshatrat rreth Prizrenit, dhe në Drenicë, me zhbërjen e shtetit të car Dushanit, pas betejës së Maricës më 1371, dokumentet raguziane dhe osmane dëshmojnë se Prizrenin, Pejën dhe krejt Rrafshin e Dukagjinit e zotëruan kryezotërit shqiptarë Ballshajt, Kastriotët e Dukagjinët. Janë të shumtë dokumentet historike për prezencën masive të shqiptarëve në Kosovë e në Maqedoni në mesjetë. Shqiptarët e Kosovës edhe në histori janë karakterizuar me shtim relativisht të lartë të popullsisë i cili po vazhdon akoma por me një ritëm më të zbehur falë zhvillimit të përgjithshëm të tyre.

Sipas Planit Strategjik:

Shtimi i përgjithshëm vjetor është 2,60221 % ose 26 në 1.000 banorë

Mesatarja e shtimit natyror (lindjet 18 – vdekjet 4) është 14 në 1.000 banorë

Rrjedhimisht, bilanci vjetor i migrimit është 12 në 1.000 banorë

Nga 75% të anketuarit e lagjes së Muhaxhirëve rrjedh se nr. i banorëve të tanishëm është 5251, nëse e shtojmë duke supozuar përqindjen e ngelur rrjedh se nr. Ekzistues i banorëve në lagjen e Muhaxhirëve është rreth **7500 banorë**. Duke u bazuar në të dhënat ekzistuese dhe në supozimet rrjedh se në lagjen e Muhaxhirëve deri në vitin 2030 do kemi këtë rritje të popullsisë: Shtimi i popullsisë nga shtimi natyror do të jetë 10.429 në v. 2020 dhe **12.465** në v.2030; Në lagjen e Muhaxhirëve në qoftëse të gjithë pronarët bashkohen dhe bëhet shfrytëzimi maksimal i koeficientave duke u realizuar 100% Plani Rregullues ka mundësi që të arrij numri i banorëve deri në **33.167** banorë.

Projeksioni i opullsisë		2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
<b>KOMUNA E PRISHTINËS</b>	ban.	423,000	439,920	457,517	475,817	494,850	507,221	519,902	532,900	546,222	559,878	573,874
perqindja e rritjes	%	4.0%	4.0%	4.0%	4.0%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%
<b>Pjesa Urbane</b>	ban.	366,500	381,160	396,406	412,263	428,753	439,472	450,459	461,720	473,263	485,095	497,222
perqindja e rritjes	%	4.0%	4.0%	4.0%	4.0%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%	2.5%
<b>Pjesa Rurale</b>	ban.	56,500	58,760	61,110	63,555	66,097	67,749	69,443	71,179	72,959	74,783	76,652

fig. 47. Numri i banorëve në Komunën e Prishtinës

Projeksioni i opullsisë		2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
<b>KOMUNA E PRISHTINËS</b>		588,221	602,927	618,000	633,450	642,952	652,596	662,385	672,321	682,406	692,642	703,031
perqindja e rritjes		2.5%	2.5%	2.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%
<b>Pjesa Urbane</b>		509,653	522,394	535,454	548,840	557,073	565,429	573,910	582,519	591,257	600,126	609,128
perqindja e rritjes		2.5%	2.5%	2.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%
<b>Pjesa Rurale</b>		78,569	80,533	82,546	84,610	85,879	87,167	88,475	89,802	91,149	92,516	93,904

### Dendësia e popullsisë

Rritjen e dendësisë së popullsisë e shkakton shtimi intenziv i popullsisë, imigrimi i popullsisë, zhvillimi ekonomik, rritja e popullsisë në qytete. Në Kosovë dendësia e popullsisë për 43 vite është rritur nga 67 b /km<sup>2</sup> në vitin 1948 në 176 b/km<sup>2</sup> në vitin 1991, ose për 2,67 herë. Dendësia e popullsisë nuk është e njëjtë në të gjitha viset e saja. Ajo është më e vogël në viset malore, ndërsa më e madhe në viset fushore, luginat lumore, në qytete dhe afër tyre. Në viset fushore dendësia e popullsisë në vitet e 90ta kishte arritur në rreth 300 b/km<sup>2</sup>, gati si në shtetet më të dendura të Evropës (Beneluksit). Deri në vitin 1953 në pjesën më të madhe të komunave të Kosovës dendësia sillej në mes 51 – 100 b/km<sup>2</sup>, ndërsa në vitin 1991 sillej në mes 150 e 300 b/km<sup>2</sup>. Dendësia më e lartë është në kryeqytetin tonë.

### Struktura gjinore e popullsisë

Deri në vitet e 90-tapopullsia e Kosovës veçohej me pjesëmarrje më të lartë të popullsisë mashkullore - 51,6 % se ajo femrore – 48,4 %. Ndërsa pas luftës popullsia e Kosovës ka pjesëmarrje më të lartë të popullsisë femrore - 51,2% se ajo mashkullore 48,8% për shkak të emigrimit të popullsisë mashkullore.

### Struktura arsimore e popullsisë

Pas tërheqjes së Turqisë, në asnjë sferë të jetës shoqërore, nuk ndryshoi gjë në të mirë të shqiptarëve. Regjimi hemonist i Jugosllavisë së Versajës (1919) jo vetëm që nuk lejoi hapjen e shkollave dhe veprimtarinë botuese në gjuhën shqipe, por edhe e ndaloi përdorimin e kësaj gjuhe në jetën publike. Në këtë periudhë gati e tërë popullsia shqiptare ishte analfabete. Ky regjim as që kishte gatishmëri dhe përpjekje që njerzve t'u sigurohente bazat e arsimit elementar dhe të njohurive profesionale, veçanarisht jo për kombin shqiptar, i cili shkollat e para në gjuhën e vet do t'i fillojë vetëm pas Luftës së II Botërore. Kosova në kohën e Pas Luftës së Dytë Botërore njihet si territor me pjesëmarrje të lartë të popullsisë analfabete, në vitin 1948 në Kosovë ishin 62,5% analfabetë, ndër femra ishin 78,4 % analfabete. Kjo gjendje ishte e tillë në mungesë të shkollave shqipe. Me hapjen e tyre zvoglohet numri dhe pjesëmarrja e analfabetëve dhe rritet numri i të shkolluarëve i profileve të ndryshëe. Në vitin 1981 kishte 17,6 % analfabet në tërësi, edhe pse kjo përqindje të të moshuarit ishte mjaft e lartë. Në vitin 1999 pjesëmarrja e analfabetëve vlerësohej në 6,5%, ndër meshkuj të moshuar 10%, ndër femra 50%.

Popullsia e Kosoves për dy dekada të ndryshimeve intensive shoqërore, ka arritur që ta ngrisë nivelin e arsimit të popullsisë për 3 here, Bosna e Hercegovina për 2 here etj.



Gjate periudhes 20 vjeçare Kosova e ngriti pjesëmarrjen e popullsisë me arsim të mesem për 4,4 here (prej 3,9 në 17,3%), ndërsa të popullsisë me arsim të lartë e superior për 5,5 here (prej 0,6 në 3,3%)

Të dhënat për vitin 1953 tregojnë se 54,8% e popullsisë me 10 e më shumë vjet ishte analfabete (38% mashkujt dhe 72,1% femrat), 16,4% kishte 1-3 klasë, 22,8% kishte 4-7 klasë, vetem 1,9% 8 klasë dhe 1,1% ndonjë shkollë të mesme.

## 16 INFRASTRUKTURA SOCIALE

Zhvillimi i mirëfillt i lagjes së Muhaxhirëve duhet të shoqërohet me një aplikim adekuat të infrastrukturës sociale për banorët e tanishëm dhe ata që do vinë. Një vlerësim i kërkesave të ardhshme të infrastrukturës sociale megjithatë vështirësohet nga mungesa e të dhënave demografike.

Për të bërë të mundur vlerësimin e kërkesave për infrastrukturën sociale pavarsisht këtyre të metave skica e llogaritjes është bërë me supozim.

Numri i fëmijëve duke iu referuar strukturës së moshave në Kosovë, një grupmoshë mesatare e fëmijëve përfaqëson afërsisht 2% të popullatës totale. Norma e fertilitetit supozohet të ulët me ndryshimin e kushteve të jetesës në Prishtinë, një pjesë 1.5% për grupmosha të zakonshme të fëmijëve është vlerësuar. Duke u bazuar në këto supozime dhe në sipërfaqen e mundshme të ndërtimit supozohet se në lagjen e Muhaxhirëve do jetojnë me **tab. 1 rreth 13.360 ban;** me **tab.2 27.982 ban;** dhe maksimumi me **tab.3 - 33.528 banorë.**

Duke llogaritur në bazat e madhësive standarde, numrin e fëmijëve në përkujdesjen e nevojshme edukative rrjedh se fitojmë këto të dhëna:

totali i banorëve sipas skenarit 1:		13,412								
seksioni i edukimit dhe moshë	nr. fëmijë /1000ba.	nr. i fëmijëve	turnet	Sip. parcelës për fëmijë (m <sup>2</sup> /fëmijë)	gjithësej Sip. parcelës (m <sup>2</sup> )	Sip. e objektit (m <sup>2</sup> )	Sip. tot.e objekteve (m <sup>2</sup> )	m <sup>2</sup> /fëmijë	Fëmijë në objekt	Nr. ob. të nevojshëm
Çerdhe & Kopesht (0-6 v.)	70	939	1	20	18,777	850	4,694	5	170	6
Edukimi Fillor (6-12 v.)	180	2414	2	12	14,485	4,800	7,242	6	800	2
Shkolle e Mesme Ulet & Mesme (12-18 v.)	50	671	2	13	4,359	3,000	2,012	6	500	1
<b>totali i fëmijëve:</b>		<b>4024</b>	<b>1-2</b>	<b>12-20</b>	<b>37,621</b>		<b>13,948</b>	<b>5-6</b>		<b>9</b>

fig. 48. Nr. i fëmijëve dhe objekteve edukativo-shkollore sipas tab. 1

totali i banorëve sipas skenarit 2:		28,113								
seksioni i edukimit dhe moshë	nr. fëmijë /1000ba.	nr. i fëmijëve	turnet	Sip. parcelës për fëmijë (m <sup>2</sup> /fëmijë)	gjithësej Sip. parcelës (m <sup>2</sup> )	Sip. e objektit (m <sup>2</sup> )	Sip. tot.e objekteve (m <sup>2</sup> )	m <sup>2</sup> /fëmijë	Fëmijë në objekt	Nr. ob. të nevojshëm
Çerdhe & Kopesht (0-6 v.)	70	1968	1	20	39,359	850	9,840	5	170	12
Edukimi Fillor (6-12 v.)	180	5060	2	12	30,362	6,600	15,181	6	1100	2
Shkolle e Mesme Ulet & Mesme (12-18 v.)	50	1406	2	13	9,137	3,600	4,217	6	600	1
<b>totali i fëmijëve:</b>		<b>8434</b>	<b>1-2</b>	<b>12-20</b>	<b>78,858</b>		<b>29,238</b>	<b>5-6</b>		<b>15</b>

fig. 49. Nr. i fëmijëve dhe objekteve edukativo-shkollore sipas tab. 2

totali i banorëve sipas skenarit 3:		33,685								
seksioni i edukimit dhe moshë	nr. fëmijë /1000ba.	nr. i fëmijëve	turnet	Sip. parcelës për fëmijë (m <sup>2</sup> /fëmijë)	gjithësej Sip. parcelës (m <sup>2</sup> )	Sip. e objektit (m <sup>2</sup> )	Sip. tot.e objekteve (m <sup>2</sup> )	m <sup>2</sup> /fëmijë	Fëmijë në objekt	Nr. ob. të nevojshëm
Çerdhe & Kopesht (0-6 v.)	70	2358	1	20	47,159	850	11,790	5	170	14
Edukimi Fillor (6-12 v.)	180	6063	2	12	36,380	6,600	18,190	6	1100	3
Shkolle e Mesme Ulet & Mesme (12-18 v.)	50	1684	2	13	10,948	3,600	5,053	6	600	1
<b>totali i fëmijëve:</b>		<b>10106</b>	<b>1-2</b>	<b>12-20</b>	<b>94,487</b>		<b>35,033</b>	<b>5-6</b>		<b>18</b>

fig. 50. Nr. i fëmijëve dhe objekteve edukativo-shkollore sipas tab. 3

Të gjitha strukturat e integritit janë të integruara kryesisht me sipërfaqet rezidenciale dhe sipërfaqet mikse.

### Sheshet e lojrave dhe paisjet sportive

Përveç përkujdesjes ndaj fëmijëve dhe paisjeve shkollore një numër i bollshëm i shesheve për lojra duhet të vendosen në këtë lagje. Në përputhshmëri me standardet gjenerale të planifikimit urban një sipërfaqe prej 1m<sup>2</sup> e sheshit për lojë për banorë për fëmijët e moshës 3-11 vjeç është e nevojshme. Sheshet e lojrave duhet të jenë pjesë integrale e fqinjësisë në formësimin e blloqeve të vogla të banimit. Sheshet e lojrave do të integrohen çdokund brenda zonës së banimit dhe atë mikse. Sa i perket paisjeve sportive që duhet të jetë 1.5m<sup>2</sup>/ban. Edhe këto do të organizohen në njësitë e bllokut e disa prej tyre do të jenë të grupuara në hapësirat e shkollave që të mund të shfrytëzohen edhe nga komuniteti.

Për shkak të mungesës së pronës komunale është pak vështirë të realizohen këto hapësira por me dashurin ndaj jetës, fëmijëve vendit tone, hap pas hapi do të vij deri te implementimi i tyre.

Plani rregullues urbanistik i lagjes parasheh zgjerimin e rugeve ekzistuese dhe hapjen e disa rrugëve të reja. Një strategji e fillë implementuese duhet të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me banorët e zonës me qëllim të krijimit të një ambient të këndshëm për jetesë.

Kjo shihet si objektiv afatgjatë dhe do të realizohet brenda planifikimit të kërkesave hap pas hapi.



## 17 RREGULLIMI I SIPËRFAQEVE GJELBËRUESE

Prishtina ka 3.8 m<sup>2</sup> sipërfaqe të gjelbëruara për banorë, që është gati dhjetë herë më pak se nga rekomandimet dhe standardet botërore. Duhet që ky raport të përmirësohet dhe sipërfaqet ekzistuese të gjelbëruara të mbrohen nga ndërtimi i cdo lloj objekti, kiosku ose platoje.

Të gjitha sipërfaqet e gjelbëruara duhet t'i përgjigjen funksionit dhe të jenë të lidhura në sistemin e veçantë të sipërfaqeve të gjelbëruara të qytetit, funksioni i të cilave është ajrosja e qytetit dhe përmirësimi i kushteve për jetë dhe punë në të.

Qëllimet kryesore të punës sonë janë mbrojtja e fondit ekzistues të gjelbërimit dhe sipërfaqeve të destinuara për gjelbërim, pasurimi i sipërfaqeve ekzistuese, ngritja e gjelbërimit dhe raporti i rregullt me ato me qëllim të rritjes së karakteristikave funksionale dhe vizuale.

Me gjelbërimin e shesheve, kryqëzimeve fitohet numër i madh i sipërfaqeve të vogla gjelbëruese të cilat e hijeshojnë, pastrojnë dhe lidhin qytetin. Këto sipërfaqe të gjelbëruara nuk duhet të pengojnë komunikacionin në zvogëlimin e shikueshmërisë. Fondi i gjelbërimit ndikon në qetësimin e vozitësve dhe zvogëlon mundësinë e fatkeqësive nëse bëhet vendosja e rregullt.

Para objekteve të rëndësishme shoqërore, hoteleve, shitoreve është e nevojshme të gjelbërohet hapësira që sigurisht se do ta rris komoditetin e jetës dhe punës.

Me zhdukjen e njëres apo disa sipërfaqeve të gjelbëruara do të çrregullohet funksioni i sistemit të tillë të menduar të gjelbërimit. Njëkohësisht mangësia e sipërfaqeve të veçanta nga mosmirëmbajtja do ta zvogëlojë rolin dhe rëndësinë e tyre.

Programi i masave për mirëmbajtjen dhe kujdesin e sipërfaqeve të gjelbëruara duhet të bëhet në bashkëpunim me institucionet e kualifikuara.

Lagjja "Muhaxhirët" ka një sipërfaqe prej 60.7ha, dhe gjindet pothuajse në zemrën e kryeqytetit.

Gjatë projektimit duke marrur parasysh gjendjen aktuale ekzistuese që ka, e kemi organizuar në atë mënyrë që mos të ndihet shumë mungesa e gjelbërimit që është i shpërndarë njëtrajtësisht por me sasi jo edhe aq të mjaftueshme duke patur në konsideratë pronësinë private dhe vlerën ekonomike të tokës në atë zonë.

### Funksioni ekologjik dhe rekreativ i hapësirave të gjelbërta

Influenca e vegjaticionit ndaj shëndetit të njeriut ndihet në formë direkte ose indirekte. Duke llogaritur se sipërfaqja e gjelbërt e paraparë në këtë lagje është më shumë e shpërndarë në njësi të blloqeve të banimit sesa në hapësira publike të mëdha ashtu që në total mbulon një sip. prej 26.1ha që i bie rreth 43% të totalit të sipërfaqes së lagjes.

Sip. gjelb në blloqet e banimit kolektiv	16.9 ha
Sip. gjelb në banimin rezidencial	1.53 ha
Sip. gjelb në hap publike	<u>7.67 ha</u>
Sip. tot.e gjelb.	<b>26.1 ha</b>

Kjo hapësirë e gjelbërt e lagjes do të krijojë një mikroklimë të përshtatshme për banorët dhe vizitorët e kësaj lagjeje.

Gjithashtu një rëndësi të madhe për këtë lagje dhe për kryeqytetin është afërsia e saj me parkun e qytetit ku banorët mund ta shfrytëzojnë për dalje, rekreim, lojë dhe argëtim.

Në një hapësirë ku ka vegjetacion krijohet një atmosferë dhe një ambient i këndshëm për banim dhe punë.

Do të aplikohet stili gjeometrik deh peisazhor i gjelbërimit, përgjatë disa rrugëve, brendësisë së blloqeve, parkut memorial, etj.

